



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
"Mësuesi në Matematikë-Informatikë"**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër  
Moisiu"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ana KTONA

2. Prof. As. Dafina XHAKO

Shkurt/ 2024

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit në Master i Shkencave në “Mësuesi në Matematikë-Informatikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Mësuesi në Matematikë-Informatikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 656, datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 165, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE/ 2 PAK
18	Numri i studentëve: (2021- 2023)	48 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës u ofron studentëve të Ciklit të Dytë një program të ri në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, programin Master Shkencor në Mësuesi në “Matematikë-Informatikë”, me 120 ETCS, prej vitit akademik 2018–2019.

Ky program studimesh synon të përgatisë mësuesit e Matematikës dhe Informatikës për nivelet e Arsimit të Mesëm të Ulët dhe të Lartë në vend, duke përdorur metodat më efektive të mësimdhënies.

Qëllimi kryesor i këtij programi është të sigurojë një përgatitje profesionale të mësuesve për lëndën e matematikës dhe informatikës në nivelin parauniversitar, dhe të ndihmojë në zhvillimin e tyre të suksesshëm profesional në sistemin e arsimit parauniversitar.

Programi ka një përputhje të mirë midis objektivave të tij dhe kompetencave bazë që duhet të kenë studentët pas përfundimit të këtij programi studimi.

Kurset e përfshira në kurrikul ofrojnë njohuritë teorike të nevojshme dhe aftësitë profesionale të kërkuara, duke e mbështetur rolin e mësuesit të matematikës dhe informatikës në shkollat parauniversitare. Këta mësues mbështesin zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të nxënësve në tre fusha kryesore: krijimi i mjedisit mësimor të integruar, përdorimi i metodave dhe teknikave të mësimdhënies dhe krijimi i materialeve mësimore në fushën e tyre të specializimit.



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Faqe 3

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master në Mësuesi në “Matematikë-Informatikë” filloi me prezantimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe organizimin e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, u realizua gjatë datave 03-04.07.2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga koordinatori teknik i ASCAL, i caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e tij. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL Znj Aviola Bardhi.

Më datë 15.02.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/33 Prot., datë 15.02.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 22.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 384, datë 21.02.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Matematikë-Informatikë”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Funskionimi i UAMD zhvillohet mbi bazën e nje sërë dokumentash strategjike që rishikohen dhe rivlerësohen në mënyrë të vazhdueshme. UAMD evidenton se ofron programe studimi në përputhje e në shërbim të interesave kombëtare të vendit, duke zbatuar Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, kreu 1, neni 1. UAMD dhe ka në qendër të punës së tij respektimin e ruajtjen e vlerave akademike, kulturore e kombëtare, duke vënë në shërbim të këtij synimi kapacitetet njerëzore e intelektuale. UAMD synon arritjen e zhvillimit e një sistemi arsimor gjithë përfshirës, për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë pa dallime të asnjë lloji. Në Planin e Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të UAMD-së theksohet se programet e studimit kanë qëllim të përbashkët zhvillimit e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë” 80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit, Statutin e UAMD, dhe gjithë bazën ligjore në fuqi. Ky program studimi u hap si nevojë e kohës dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut për profesionistë në fushën e mësuesisë.</p> <p><i>Evidence 2 _Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës</i>  <i>Evidence 3 _Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026</i>  <i>Evidence 6 _Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit ka adresuar nevojat e tregut në funksion të plotë me prioritetet kombëtare strategjike. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin e UAMD, me qëllimet e këtij universiteti, duke synuar arritjen e standardeve akademike, bashkëkohore e ndërkombëtare, në përkrahje të aspiratave akademike dhe arritjet e gjithkujt që kërkon të përfitojë nga arsimit i lartë. Qëllimi i këtij programi studimi të ciklit të dytë me studentin në qendër, dokumentohet në Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit. Në dokumentacionin strategjik për zhvillim të UAMD si Statuti, Rregullore e Universitetit dhe programit theksohet se objektivi i këtij programi studimi mbështetet në misionin dhe qëllimin që mbart UAMD si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> <p><i>Evidence 1 _Mendimi i Dekanit</i>  <i>Evidence 4 _Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i>  <i>Evidence 5 _Rregullore Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 6 _Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është përpjekur të reflektojë ndryshimet e tregut, të ruajë cilësinë e mësimdhënies në nivele të larta, të reflektojë ndryshimet e nevojshme me qëllim përputhshmërinë e dokumentave kryesore strategjike mbi të cilat mbështetet funksionimi i institucionit, duke filluar që nga Statuti i UAMD, plani strategjik dhe rregulloret përkatëse. Bazuar në dokumentacionin dhe evidencat e dorëzuara nga UAMD, ky program studimi është hartuar në përputhje me strategjinë e UAMD. Në këtë dokument institucioni thekson rëndësinë e përmirësimit e rritjes së cilësisë së programit të studimit në zbatim të strategjisë së UAMD dhe referuar Planit të Zhvillimit Strategjik të UAMD. Sipas vizitës në institucion dhe shqyrtimin e dokumentave të institucionit, ky program studimi plotëson nevojat e kërkesat e tregut për profesionistë të tregut në fushën e mësuesisë, po kështu u krijon mundësi studentëve të thellohen në kërkimin shkencor. Ky program studimi ka në qendër formimin e specialistëve, ekspertëve në fushën e mësuesisë, duke i pajisur me njohuritë e kualifikimet e duhura me synim plotësimin e kërkesave të tregut.</p> <p><i>Evidence 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës</i>  <i>Evidencë 4_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 6_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e programit MI</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i UAMD, zbaton Statutin e institucionit, neni 8, hartuar në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 dhe zhvillon veprimtarinë në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Programi i studimit është hartuar në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UAMD, si në nivel institucioni edhe të njëjësive përbërëse të tij. Planet strategjike, janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, me interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit, duke u reflektuar në planet mësimore të programit të studimit, në programet e lëndëve, por edhe duke pasqyruar ndryshimet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, në përputhje me prirjet e tendencat ndërkombëtare. Kapacitetet infrastrukturore si sallat e leksioneve, seminareve, zyrat mbështetëse jo akademike reflektojnë mbështetjen që merr ky program studimi për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit.</p> <p><i>Evidence 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës</i>  <i>Evidence 8_Personeli akademik ne FTI</i>  <i>Evidence 9_Personeli akademik në DM</i>  <i>Evidence 13_CV të lektorëve</i>  <i>Evidence 14_CV e stafit ndihmës akademik FTI</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjitha dokumentat strategjike të institucionit, fakultetit dhe njësisë bazë që ofron këtë program studimi synojnë të njëjtin mision me qëllim mbështetjen e dijes dhe njohurive që përcillen tek studentët përmes realizimit dhe përmbushjes së objektivave përkatëse. Institucioni</li> </ul>



	<i>përmbush plotësisht të gjitha kushtet dhe infrastrukturën përkatëse për të ofruar këtë program studimi në mënyrë cilësore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i UAMD, zbaton Statutin e institucionit, neni 8, hartuar në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 dhe zhvillon veprimtarinë në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Matematikës, Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit me këtë përbërje stafi: 15 anëtarë të kualifikuar, ku 4 prej tyre zotërojnë titullin Profesor i Asociuar, 6 janë me graden Doktor i Shkencave, 1 Docent. Gjithashtu programi i studimit mbulohet edhe nga personeli akademik i departamenteve të tjerë të Fakultetit të TI, i cili ka në përbërjen e tij departamentet, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Të gjithë këto departamente ndihmojnë në përmbushjen e qëllimeve akademike që ka programi i studimit MSH/MI</p> <p><i>Evidence 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës</i>  <i>Evidence 8_Personeli akademik në FTI</i>  <i>Evidence 9_Personeli akademik në DM</i>  <i>Evidence 13_CV e lektorëve</i>  <i>Evidence 14_CV e stafit ndihmës akademik FTI</i>  <i>Evidence 10_Programet e studimit të ofruara në FTI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Përputhshmëria e programit të studimit me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit është bërë e mundur me kodifikimin e programeve të studimit dhe lëndeve sipas profileve. Evidentohet nga institucioni se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore miratuar sipas vendimit 310, datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe udhëzimin nr 31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. "Mbi Procedurën për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë", dhe me vendim për kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin <b>S72MS0188</b>.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 12_Kodifikimi i programeve të studimit UAMD</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e programit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin</p>

studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	e studimit sipas fushave kërkimore të Departamentit të Matematikës. Ky program studimi vjen si nevoja për vazhdim e programeve të ngjashëm si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bachelor në “Matematikë-Informatikë”,</li> <li>- Bachelor në “Informatikë-Englisht”,</li> <li>- Bachelor në “Shkenca kompjuterike”,</li> <li>- Bachelor në “Teknologji Informacioni”,</li> <li>- Bachelor në “Sisteme Informacioni”,</li> </ul> <i>Evidence 12_Kodifikimi i programeve të studimit UAMD</i> <i>Evidence 31_Rregullore e programit MMI</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UAMD u jep mundësi studentëve të informohen për mundësitë e punësimit, për të kryer praktika mësimore, për trajnime sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel universiteti e fakulteti. I gjithë informacioni promovohet në faqen zyrtare të internetit të UAMD, në rrjetet sociale të Departamentit të Matematikës dhe dërgimit të emaile-ve studentëve sipas programeve të studimit.  <i>Evidence: Tabelat përmbledhëse</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UAMD, të njësisë kryesore Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe të njësisë bazë, Departamentit të Matematikës.</li> <li>- UAMD angazhohet për ofrimin e trajnimeve të studentëve edhe pas diplomimit të tyre.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e	Në bazë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, Statutit të UAMD (neni 51), Rregullores së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (neni 24) dhe Rregullores se institucioni siguron marrëdhënie të përshtatshme bashkëpunimi, duke përcaktuar detyrat e personelit akademik dhe statusin e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik përcaktohen edhe në marrëveshjet e nënshkruara në fillim të vitit akademik mes drejtuesit të njësisë bazë dhe pedagogut lidhur me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë



<p>personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>auditorit, kontribut institucional etj. Institucioni analizon në mënyrë të vazhdueshme punën, sipas detyrave të ngarkuara dhe realizimit të tyre nga ana e personelit të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore. Bazuar në nenin 10 të Rregullores për funksionimin e organizimin e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, kreu V, në nenin 109 të Rregullores së UAMD, në nenin 24 të Rregullores së Fakultetit, në kreun 4, janë përcaktuar detyrat e personelit akademik nëpërmjet marrjes së përgjegjësiwe dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Ndarja e detyrave, ngarkesës mësimore brenda e jashtë auditorit bëhet në mbledhjet e njësisë bazë, në takimet mes grupeve të punës si edhe përmes postës elektronike. Analiza e vazhdueshme e punës së kryer vërtetohet përmes raporteve të analizës vjetore të aktivitetit akademik e atij kërkimor të Departamentit, po kështu edhe përmes analizës së ecurisë së programit të studimit dhe dosjeve të vetëvlerësimit të punës akademike e kërkimore të çdo pedagogu.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i UAMD</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidencë 25_Rregullore për funksionimin e organizimin e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e programit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumenteve shoqërues të RVB dhe vizitës në institucion, konstatohet se Departamenti në bashkëpunim me Fakultetin kanë nënshkruar marrëveshje reciproke me institucione të rëndësishme në vend si publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve. Institucioni mundëson leksione të hapura nga lektorë apo përfaqësues specialistë në fushën e programit nga institucione publike dhe private. Këto aktivitete janë në linjë me kërkesat e tregut dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat e programit të studimit. Qëllimi i këtyre bashkëpunimeve është pasurimi dhe përmirësimi i ofertës akademike dhe nxitja e kërkimit shkencor.</p> <p><i>Evidencë_Tabelat permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>UAMD ka nënshkruar marrëveshje me institucione, institute kërkimore, kompani të kësaj fushe, për realizimin e praktikave profesionale, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për realizimin e mbikëqyrjen së praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik e studentëve. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua angazhimi i UAMD për të vazhduar bashkëpunimin në bazë të kërkesës së tregut dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat sipas nevojave të tregut. Programi i studimit i ka shfrytëzuar këto marrëveshje të bashkëpunimit për: të mësuarit përmes kryerjes së praktikave mësimore; për ofrimin e praktikave bashkëkohore e ndërkombëtare në fushën e programit të studimit, specifikuat në matematikë dhe informatikë (duke kryer trajnime/leksione të hapura) për lidhjen e programit të studimit me tregun e punës, që është arritur përmes kryerjes së panareve të punës (aktivitet vjetor).</p> <p><i>Evidencë 27_Tabelat Kerkimi Shkencor per vitin akademik 2021-2022 MI</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p><i>Evidencë Tabelat permbledhese</i></p> <p>Qasja ndërkombetare e UAMD dhe fokusi është plotësimi i nevojave të vendit për dije dhe kompetenca që sjellin si nevojë një larmishmëri marrëdhëniesh me biznese apo njësi akademike brenda dhe jashtë vendit. Në mënyrë të veçantë njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione apo biznese, në funksion të realizimit të programit të studimit. Në zbatim të marrëveshjeve, interesi ka qenë reciprok, si nga ana e UAMD ashtu edhe nga ana e kompanive apo e institucioneve për të marrë pjesë në leksione të hapura në fakultet për studentët e këtij program studimi, duke ofruar internship për studentët, duke lejuar edhe zhvillimin e praktikave profesionale në institucione, në zbatim të programit mësimor të lëndës/ve përkatëse. Studentët e këtij program studimi, kanë patur mundësi të marrin informacion, të kryejnë praktika mësimore, apo edhe të punësohen në këto institucione. I gjithë ky proces bashkëpunimi ka qenë në qendër të analizave për përfitimet nga ky bashkëpunim.</p> <p><i>Evidencë Tabelat permbledhese</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione akademiko-kërkimore në vend por edhe të huaja. Institucioni ka lidhur marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale institucione publike dhe private.</li> <li>- Në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të UAMD, Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentit të Matematikës analizohen marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit të angazhuar në këtë program studimi.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, është kryer në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, pika 2. Programi i studimit organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 120 ETCS. Kohëzgjatja është 2 vite akademike, me katër semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit. Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet e studimit të ciklit të dytë (master), përkatësisht:</p> <p>A – lëndë bazë - 5-10%;</p> <p>B – lëndë karakterizuese – 50-60%;</p> <p>C – lëndë ndërdisiplinore/integruese – 12-20%;</p> <p>D – lëndë plotësuese – 10%;</p> <p>E – veprimtaritë përmbyllëse – 10-15%</p> <p><i>Evidencë 36 Rregullore e programit MMI</i>  <i>Evidencë 41 Plani mesimor MMI</i>  <i>Evidencë Suplement Diplome MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit u ofron studentëve një diplomë universitare, e cila u jep njohuri dhe aftësi për të punuar në një mjedis të larmishëm. Ky program studimi synon të realizojë formimin e shprehive të veçanta për shumë lloje profesionale e specialitetesh pasi ka kryer analizën e tregut të punës. Në programin e studimit që po akreditohet janë vendosur objektiva të qartë për lidhjen e studimeve të ciklit të dytë me studimet e mëtejshme, si ato doktorale. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Ky kriter plotësohet më së miri përmes reflektimeve të identifikuara tek dokumentacionet bazë që nga Statuti dhe rregulloret në nivel njësie bazë dhe kryesore, e deri tek diskutimet me stafet akademike dhe ato të GVB ku synimi i tyre është edhe përmirësimi i syllabuseve të lëndëve, aktivitetet e ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave profesionale, leksionet e hapura. Lektorët e këtij masteri sjellin në auditor metoda inovative për të aftësuar studentët. Në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të programit të studimit gjatë semestrave të studimit, studentët zhvillojnë lëndë bazë të detyrueshme, kombinuar me lëndët karakterizuese, dhe lëndë të tjera ndërdisiplinore dhe /ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup lëndë me zgjedhje, ku i jepet rëndësi edhe lëndëve plotësuese. Në semestrin e katërt/fundit studentët realizojnë praktikat profesionale, të cilat zhvillohen tek institucione publike dhe private, në përputhje me marrëveshjet e</p>

	<p>përbashkëta të nënshkruara nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Matematikës për këtë element të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i UAMD</i>  <i>Evidence 4_Rregullore e Universitetit</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e programit MMI</i>  <i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidencë 41_Plani mesimor MMI</i>  <i>Evidencë 42_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga institucioni dhe vizitës së zhvilluar në UAMD, konstatohet se ky program studimi parashikon ngarkesën në kredite për praktikën profesionale të studentëve, sipas VKM 41, pika 2.4 dhe udhëzimit nr 31, datë 29.12.2017 për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga IAL-të dhe mbështetur në planet mësimore dhe kurrikulat e ndryshuara në vitin akademik 2022-2023, të miratuara në department.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit është përcaktuar qartë klasifikimi i lëndëve dhe vlerësimi i tyre me kredite sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr. 41. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese janë përlllogaritur duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës.</p> <p>Projekti i Diplomimit është një element i rëndësishëm i programit të studimit ku studentit i caktohet një udhëheqës i cili është kompetent për ecurinë dhe zhvillimin e projektit të kërkimit. Në fund të procesit të projektit të kërkimit, pasi mbikëqyrësi kryen vlerësimin, studenti prezanton tezën përpara një komisioni ad hoc të caktuar nga sikurse specifikuar sipas Rregullores së Departamentit dhe Rregullores së Projektit të Diplomimit. Në lidhje me praktiken ajo zhvillohet si lëndë e veçantë për t'u plotësuar në semestrin e dytë të vitit të tretë. Studentët duhet të akomodohen në nje biznes/organizatë/institucion për të kryer praktikën e tyre profesionale. Në përfundim të praktikës përgatitet një raport i cili i dorëzohet titullarit të lëndës dhe përdoret për vlerësimin e studentit.</p> <p><i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidencë 41_Plani mesimor MMI</i>  <i>Evidencë 42_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit</p>	<p>Programi i ciklit të dytë “Master Shkencor” në Mësuesi Matematikë-Informatikë, që ofrohet ng FTI në UAMD, formon mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. Ky program vjen si vazhdimësi dhe plotësim i programit Bachelor në Matemaikë – Informatikë të ofruar nga ky institucion.</p> <p><i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidencë 41_Plani mesimor MMI</i>  <i>Evidencë 42_Tabelat Permbledhese</i></p>



<p>të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë “Master Shkencor” në Mësuesi Matematikë-Informatikë, që ofrohet ng FTI në UAMD, është i organizuar në 120 kredite nga ku 25 % e tyre janë në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Lëndët ndahen sipas kategorive:</p> <p>A– lëndë bazë - 5-10%;</p> <p>B – lëndë karakterizuese – 50-60%;</p> <p>C – lëndë ndërdisiplinore/integruese – 12-20%;</p> <p>D – lëndë plotësuese – 10%;</p> <p>E – veprimtaritë përmblylëse – 10-15%</p> <p>Lëndët që zhvillohen janë të gjitha 6 kredite:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shkenca të Edukimit – Lëndë e Detyrueshme</li> <li>2. Didaktika e Matematikës - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>3. a) <i>Histori e mendimit Matematike</i> – Lëndë me zgjedhje</li> <li>   b) <i>Sisteme Multimediale</i> – Lëndë me zgjedhje</li> <li>4. <i>Aplikacione Komjuterike</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>5. <i>Plotesime ne Algjeber</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>6. <i>Psikologji e Zhvillimit</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>7. <i>Programim i Avancur në WEB</i>- Lëndë e Detyrueshme</li> <li>8. a) <i>Elementë të logjikës matematike</i> – Lëndë me zgjedhje</li> <li>   b) <i>Cështje speciale në Probabilitet-Statistikë</i> – Lëndë me zgjedhje</li> <li>9. <i>Cështje speciale në Analizë</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>10. <i>Hyrje në Kombinatorikë</i>- Lëndë e Detyrueshme</li> <li>11. <i>Gjeometri</i>- Lëndë e Detyrueshme</li> <li>12. <i>Modelim dhe Teknika të Zgjidhjes së Problemit</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>13. <i>Algoritmikë</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>14. <i>Arkitekturë Kompjuterash</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>15. <i>Sistemet e Informacionit</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> <li>16. <i>Informatika në mësimdhënie</i> - Lëndë e Detyrueshme</li> </ol> <p><i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidencë 41_Plani mesimor MMI</i>  <i>Evidencë 42_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Sipas dokumentave mbështetëse të raportit të vlerësimit të brendshëm rezultojnë se programi i studimit referuar emërtesës, <i>nuk ka ngjashmëri në emërtesë me programe të tjera të ngjashme</i>. Sipas procedurës së kodifikimit, programi mban kodin <b>S72MS0188</b> duke filluar nga viti 2022, <i>institucioni pohon se nuk ka informacion mbi kodifikimin e programeve të tjera të ngjashme të studimit</i>.</p> <p><i>Evidencë 11_Kodifikimi i programeve të studimit UAMD</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Dokumentohet se sipas VKM nr 310, datë 11.05.2022 mbi “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Udhëzimin 31, datë 15.11.2022, “Mbi procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, përcaktimi i kodeve është hartuar duke konsideruar elementët e studimit të mëposhtëm:</p> <p>a) Nivelin e programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit;</p> <p>b) Kohëzgjatjen e programit të studimit;</p> <p>c) Llojin e programit të studimit;</p> <p>d) Fushën e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit;</p> <p>e) Gjuhën e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 11_Kodifikimi i programeve të studimit UAMD</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Kjo fushë nuk aplikohet për këtë program studimi</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Ky program Studimi është i strukturuar në 2 vite studimi, 4 semestra të rregullt me 120 ECTS. Plani mësimor përmban të gjithë elementët e nevojshëm. Komponentët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Nuk ka ngjashmëri në emërtesë me programe të tjera të ofruara nga IAL të tjera në vendin tonë.</i></li> <li>- <i>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi II.2</b></p>	
<p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programet e studimit krijohen sipas standardeve dhe metodave, në përputhje me Sistemin Evropian të Arsimit të Lartë. Evidentohet se Departamenti është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015.</p> <p>Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, si njësia kryesore përgjegjëse për programin Master në Mësuesi Matematikë-Informatikë është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI). Kjo njësi ka në strukturën e saj 3 departamente si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Matematikës (DM)</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK)</li> <li>3. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI)</li> </ol> <p>Përbërja e FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Matematikës (DM). Ky departament përbëhet në total nga 15 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë prej të cilëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 zotërojnë gradën shkencore Professor i Asociuar,</li> <li>- 7 zotërojnë gradën shkencore Doktor i Shkencave,</li> <li>- 1 zotëron titullin docent,</li> <li>- 3 janë me gradën Msc</li> </ul> <p>Përbërja e DM dhe e departamenteve të tjera të FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidence 3_Rregullore e Universitetit</i>  <i>Evidencë 4_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 8_Personeli Akademik në FTI</i>  <i>Evidence 10_Personeli Akademik në DM</i>  <i>Evidence 17_CV e Lektorëve</i>  <i>Evidence 19_CV e stafit ndihmës akademik ne FTI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon personel ndihmës akademik e administrativ. Njësia kryesore dhe njësia bazë mbështeten edhe tek personeli ndihmës akademik/administrativ, përmes stafit ndihmës akademik që kontribuon për programin e studimit, sekretarisë mësimore dhe laborantëve të cilët janë të angazhuar në nivel njësie kryesore.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit:</p> <p><i>Evidence 4_Rregullore e Universitetit</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 8_Personeli Akademik në FTI</i>  <i>Evidence 9_Personeli Akademik në DM</i>  <i>Evidence 13_CV e Lektorëve</i>  <i>Evidence 14_CV e stafit ndihmes akademik FTI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe</p>	<p>Në bazë të dokumentave dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, në bazë të legjislacionit në fuqi ka caktuar me vendim të njësisë bazë koordinatoren e programit të studimit, i cili mban komunikim të vazhdueshëm me drejtuesin e njësisë bazë për informim të studentëve në lidhje me programin e studimit dhe praktikat mësimore.</p>

zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Drejtuesi përgatit programin e lëndëve të ofruara dhe shpërndarjen e orëve mësimore për pedagogët e departamentit në bashkëpunim me Dekanin. Pra shpërndarja e orëve dhe e lëndëve bëhet në përputhje me natyrën e lëndëve, nevojat e departamentit dhe profilizimet e stafit perkatës, të jashtëm dhe të brendshëm. <i>Evidencë 29_Ngarkesa e normës DM dy vitet e fundit</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjës për ofrimin e programit të studimit përmbushin standardet ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën e këtyre njësive.</li> <li>- Personeli ndihmës akademik dhe administrativ në shërbim të programit të studimit të angazhuar në ndjekjen e praktikave dhe orëve laboratorike është i angazhuar në nivel departamenti dhe njësie kryesore.</li> <li>- Njësia bazë organizohet në grupe mësimore, kërkimore e shkencore, dhe ka përcaktuar koordinatorët e programit të studimit.</li> <li>- Departamenti përgjegjës për programin e studimit ka në përbërjen e saj të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si staf akademik, nga të cilët të paktën tre janë me grada shkencore ose tituj akademikë.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për këtë program studimi është njësia bazë përgjegjëse, që disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të rregullores për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të brendshëm në UAMD. Edhe në faqen zyrtare të UAMD mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirë funksionimin e këtij program studimi. Njësia kryesore dhe bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit. <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidence 36_Rregullore e Programit MMI</i> <i>Evidence 41_Plani mësimor</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe, në dy vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula e programit të studimit përmban 16 lëndë nga të cilat 12 lëndë të detyrueshme dhe 4 lëndë me zgjedhje. Në vitin e parë zhvillohen 10 lëndë, ndërsa vitin e dytë – semestrin e parë 5 lëndë. Në semestrin e dytë të vitit të dytë zhvillohet një lëndë karakterizuese. Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë në fund të të cilit mbrohet diploma. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi vlerësohet gjithsej me 120 kredite.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në total zhvillohen 16 lëndë secila me 6 kredite</li> <li>• Praktika vlerësohet 12 kredite;</li> <li>• Mikroteza vlerësohet me 12 kredite.</li> </ul> <p>GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar dhe pothuajse uniforme midis semestrave.</p> <p><i>Evidence 36_Rregullore e Programit MMI</i>  <i>Evidence 40_Syllabuset e Lëndëve MMI</i>  <i>Evidence 41_Plani mësimor MMI</i>  <i>Evidence Tabelat permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni bën njohjen e lëndëve sipas nenit 39, pika 4 dhe nenit 47 të rregullores së Fakultetit dhe sipas vendimeve të shpallura nga Fakulteti mbi transferimet. Në fillim të programit, studentët takohen me anëtarët e departamenteve dhe në fillim të çdo kursi ka një sesion të specifikuar hyrës të krijuar posaçërisht që pedagogët të ofrojnë një shpjegim rigoroz të planprogramit, rendin akademik të kursit, komponentëve të vlerësimit dhe afatet, literatura dhe paketat softuerike të aplikueshme dhe komponentë të tjerë të rëndësishëm siç janë specifikuar në planprograme.</p> <p><i>Evidence 2_Statuti i Universitetit</i>  <i>Evidence 36_Rregullore e Programit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare. Disponon edhe informacion për praktikën mësimore, si edhe për gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara sipas nenit 53 të rregullores së Fakultetit.</p> <p>Në përgjithësi syllabuset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme.</p> <p><i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidence 41_Plani mësimor</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit mbështetës, vihet re që planprogramet dhe materialet e tjera përkatëse të lëndës rishikohen çdo semestër nga instruktori i lëndës dhe rishikimet bëhen në kuadër të nevojave dhe risive në tregun e punës.</p> <p>Nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra, projekte, ese – 10% të vlerësimit total;</li> <li>• Provimi i ndërmjetëm – 40% të vlerësimit total;</li> <li>• Provimi përfundimtar - 50% të vlerësimit total.</li> </ul> <p>Literatura bazë dhe plotësuese janë pjesë e syllabusit të lëndës. Syllabuset e lëndëve përgatiten nga personeli akademik në shqip dhe anglisht, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit. Dosja e programit të studimit arkivohet sipas rregullave në fuqi.</p> <p>Ndryshimet zbatohen për të pasqyruar informacionin dhe inovacionin në lidhje me fushat specifike të studimeve që i përkasin profileve specifike; kjo</p>



	<p>për shkak të përmirësimit nga viti në vit, ndryshimeve në legjislacion, si dhe versioneve të përditësuar të literaturës dhe burimeve të tjera të disponueshme kohët e fundit që plotësojnë interesat dhe njohuritë shkencore të studentëve.</p> <p><i>Evidence 31_Rregullore e Programit MMI</i>  <i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>  <i>Evidence 41_Plani mësimor MMI</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, i cili përmban elementet përkatës të kërkuara në kuadrin ligjor.</i></li> <li>- <i>Kuadri rregullator i UAMD parashikon kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet e ciklit të dytë, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera dhe ekuivalentimit të studimeve.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi në proces akreditimi është program i ciklit të dytë të studimit. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 2 vite akademike, dhe realizohet gjithsej me 120 kredite ECTS. Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve dhe praktika mësimore si pjesë e programit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre.</p> <p>Në bazë të planit mësimor, lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentëve njohuri e përgatitje të përgjithshme. Lëndët karakterizuese lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe pajisin me formim specifik sipas karakteristikave të tij. Lëndët ndërdisiplinore dhe /ose integruese janë të mbështetura tek lëndë të fushës kryesore të studimit. Si lëndë plotësuese në program është përfshirë praktika profesionale, të cilën studentët mund të zhvillojnë pranë institucioneve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Pësha specifike që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda këtij program studimi është e përcaktuar pothuaj në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidence 31_Rregullore e Programit MMI</i>  <i>Evidence 41_Plani mësimor MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë</p>	<p>Konstatohet nga dokumentacioni se lëndët/modulet shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave</p>



<p>mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional në fushën e shërbimeve të mësimdhënies. Vlerësimi në kredite lëndëve në secilën kategori është në përputhje me fokusin e çdo lënde, si dhe pesha e lëndëve për secilën kategori është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese, duke respektuar nivelin e 25 orëve në javë bazuar në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p><i>Evidence 31_Rregullore e Programit MMI</i> <i>Evidence 41_Plani mësimor MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Kombinimi i teorisë dhe praktikës përbën një qasje themelore të programit. Për këtë program studimi ndarja e elementëve të programit sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritje e realizim të objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitete dhe punësim në përfundim të studimeve. Ndarja e veprimtarive përkon me kërkesat e punësimit duke iu referuar Studimit periodik të Tregut pas daljes së studentëve. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit, ky program ndërthur formimin teorik të studentëve me formimin praktik. Praktika mësimore si detyrim përmbyllës u jep mundësi studentëve të punësohen.</p> <p><i>Evidence 31_Rregullore e Programit MMI</i> <i>Evidence 41_Plani mësimor</i> <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i> <i>Evidence_Studim Tregu</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/ modulet e programit të studimit përditësohen vazhdimisht në departament nga instruktorët përkatës dhe miratohen nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit përkatës. Programet e lëndëve janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni, seminari, laboratorë, saktësojnë objektivat e lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që studentët të marrin aftësitë e duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë edhe literaturën bazë, të detyrueshme edhe atë plotësuese.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se pedagogët angazhohen që nëpërmjet rasteve studimore, dhe punimeve/artikujve shkencorë t’u ofrojnë studentëve njohuri sa më aktuale dhe praktike në lëndët përkatëse.</p>

	GVJ konsaton se Departamenti bën kërkesë për literaturën e nevojshme, sipas kërkesave të pedagogëve, për sigurimin e librave në mënyrë që syllabuset e lëndëve të përditësohen me literaturë të 5 viteve të fundit. <i>Evidence 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i> <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të nxënimit pas dy viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, e mundësive për të gjetur punë në përputhje me shkollimin, mundësi për të vijuar më tej studimet. Një dokument i rëndësishëm që pasqyron këto përfitime është edhe suplementi i diplomës, i cili i jepet studentëve nga Fakulteti në përfundim të studimeve e diplomimit në dy gjuhë shqip e anglisht. Po kështu, një pasqyrim i mirë i rezultateve të pritshme bëhet edhe në analizën e ecurisë së programit të studimit. <i>Evidence 41_Plani mësimor</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit ka përmbajtjen e duhur dhe i krijon studentëve mundësi për vijimësinë e mëtejshme të studimeve, natyrisht në plotësim të kriterëve. Kërkesat në fushën e arsimit janë të vazhdueshme dhe kjo është mundësi e mirë për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në këtë program.  <i>Evidence 41_Plani mësimor</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  - <i>Përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, shpërndarja mes veprimtarive formuese, raporti teori-praktikë dhe ngarkesa në kredite janë në përputhje me profilin e programit të studimit.</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuar sipas kërkesave të tregut të punës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara në cikle studimi më të larta</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të	Programi i studimit, ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur në fushën e mësuesisë, specifikisht mësuesi në Matematikë-Informatikë. Studimi i tregut, panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, i shërbejnë këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UAMD. Përmirësimet e përmbajtjes së programit të studimit reflektohen në: përmirësimin e programeve lëndore, trajnimet jashtë kurrikulare, trajnimet e personelit akademik në fusha specifike, përmirësimin

<p>diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>e infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies dhe praktikave mësimore, zhvillimin e projekteve të përbashkëta si dhe në përmirësime/përshtatje të kurrikulës së programit të studimit</p> <p><i>Evidencë 21_Pyetesor Student UAMD</i> <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka ngritur dhe zhvillon një traditë të komunikimit të pandërprerë me punëmarrësit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Në kuadër të kësaj tradite, organizohen panaire të punës, seminare me lektorë të ftuar.</p> <p>Dokumentohet në rregulloren e Fakultetit, neni 22, pika 1 se UAMD nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar studentëve. I gjithë ky proces i realizuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe Studentëve, ndihmon institucionin të përmirësojë cilësinë.</p> <p>Në zbatim të legjislacionit në fuqi UAMD, Fakulteti, në kuadrin e programit të studimit studimit ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, pra duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorë ekspertë të jashtëm (për GVB), sipas nenit 2 të rregullores së NjSBC.</p> <p>UAMD mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, konsultohet me ta rreth problematikave të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave, për të ndihmuar Departamentin në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të lidhjes së formimit teorik me atë praktik, duke u referuar edhe eksperiencave të fituara tashmë në punë prej tyre. Informacioni e lidhja me studentët e diplomuar merret përmes pyetësorëve, por edhe takimeve, konferencave, mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me Alumni të këtij fakulteti e programi studimi.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidencë 21_Pyetesor Student UAMD</i> <i>Evidence 23_Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidence 31_Rregullore e Programit MI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>UAMD është i përkushtuar për të mbajtur bashkëpunimin dhe partneritetin me institucionet e tjera. Prioritet i jepet bashkëpunimit me universitete të tjera, OJF, administratën publike dhe institucione të tjera. Departamenti në bashkëpunim me institucione publike e private, në zbatim të marrëveshjeve me to, përmirëson, përditëson programin e studimit në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut, në përputhje me kërkesat e institucioneve publike dhe private, duke përfshirë përfaqësues të tyre në mësimdhënie, në leksione të hapura sipas fushës së studimit të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD është i angazhuar në një program të vazhdueshëm të përmirësimit të kurrikulave të të gjitha programeve që ai ofron duke reflektuar opinione të paleve të përfshira, si studentët dhe përfaqësues të fushës së arsimit.</li> <li>- Institucioni angazhohet që të përmirësojë programin e studimit nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të jashtëm në këtë fushë, në mënyrë që të</li> </ul>

	<i>garantohet një proces serioz dhe cilësor i hartimit/rishikimit të kurrikulave të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.6

#### Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit, ka pasqyruar qartë në te prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe të kërkimit shkencor. Programi i studimit ka në bazë edhe Planin Strategjik të Fakultetit dhe Planin Strategjik të Departamentit. Sipas planit strategjik të institucionit, kërkimi shkencor mbetet një nga prioritetet strategjike kryesore, fokusuar në nxitjen dhe promovimin e ekselencës akademike. Kjo reflektohet në shumëllojshmërinë e fushave të studimit specifike dhe ndërdisiplinore, në rritjen e produktit shkencor të stafit akademik si edhe nëpërmjet promovimit e diskutimit të rezultateve kërkimore nëpërmjet organizimit të konferencave, workshop-eve, tryezave të rumbullakëta, simpoziumeve, etj.</p> <p><i>Evidencë 6_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i>  <i>Evidencë 27_Tabela kërkimit Shkencor per vitin akademik 2021-2022 MI</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>Fakulteti dhe Departamenti koordinojnë e drejtojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore e shkencore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Kjo veprimtari rregullohet me anë të marrëveshjes së personelit akademik e drejtuesit të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Në fillim të vitit akademik, në departament ndahet ngarkesa mësimore sipas semestrave, sipas planit mësimor dhe orarit zyrtar të shpallur edhe në faqen zyrtare të institucionit. Përveç leksioneve e seminareve, zhvillohen edhe leksione të hapura nga personalitete të fushës së arsimit, të institucioneve të ndryshme publike dhe private për të paraqitur eksperiencat e tyre me pedagogët e studentët. Edhe konferencat shkencore të Fakultetit, por jo vetëm janë mundësi e mirë për koordinimin e veprimtarisë akademike e asaj kërkimore. Liria akademike e personelit sanksionohet në nenin 5 të statutit të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i>  <i>Evidencë 66_Ngarkesa e normes DM dy vitet e fundit</i>  <i>Evidencë 27_Tabela kërkimit Shkencor per vitin akademik 2021-2022 MI</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Programi i studimit është ndërtuar në mënyrë të tillë që të nxisë e përgatisë studentët të përfshihen në studime e projekte, apo në aktivitete kërkimore së bashku me pedagogët e tyre. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se në konferencat shkencore të organizuara nga Fakulteti, ftohen të bëhen pjesë e punimeve edhe studentët, qoftë për të përgatitur e prezantuar apo edhe për të marrë pjesë.</p> <p><i>Evidencë 27_Tabela kërkimit Shkencor per vitin akademik 2021-2022 MI</i>  <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentat konstatohet se UAMD për të nxitur punën kërkimore dhe për të ngritur nivelin akademik e kërkimor të personelit akademik të programit të studimi, financon pjesëmarrjet në konferenca, apo botimet e artikujve në revista me Scopus, duke rimbursuar tarifën e paguar nga personeli akademik. Kjo është një formë e mirë dhe një mekanizëm i përshtatshëm për të inkurajuar veprimtarinë kërkimore.</p> <p><i>Evidencë 27_Tabela kërkimit Shkencor per vitin akademik 2021-2022 MI</i> <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi i studimit përcakton qartë në rregullore prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</li> <li>- Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon stafin akademik dhe studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, për financimin e të cilave njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni, por nevojitet një angazhim dhe përfshirje reale e studentëve.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b> <b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit, mbështet grupet e lëndëve dhe projektet e reja kërkimore shkencore dhe siguron bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p> <p><i>Evidencë_Projekte Fituese</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti përgjegjës zhvillon analiza të punës kërkimore shkencore çdo vit dhe e raporton; zhvillon studime e projekte me karakter kërkimor shkencor; miraton fushat e studimit të doktoraturës, të cilat i miraton njësia kryesore. Për hartimin e projekteve angazhohet i gjithë personeli akademik. Për arritjen e objektivave të kërkimit angazhohen e nxiten edhe studentët e programit të studimit. Edhe përmes përgatitjes së punimit diplomës apo mikrotezës, bashkëpunimi pedagog student është i rëndësishëm për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor. <i>Evidence_Tabelat Permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë</p>	<p>Fakulteti realizon Konferencën e Fakultetit, në të cilën marrin pjesë personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, studentë alumni, studentët e programit të studimit. Ata angazhohen në përgatitje e prezantim punimesh apo edhe si pjesëmarrës dëgjues. Konferencat shkencore ndihmojnë si personelin</p>



personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	akademik edhe studentët për të arritur objektivat e punës kërkimore e shkencore.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	UAMD, përmes programit të studimit ka si objektiv formimin e profesionistëve konkurrues në fushën e edukimit. Përmes mobiliteteve Erasmus +, në kuadrin e ndërkombëtarizimit ky program u ofron studentëve mundësi studimi, praktikash mësimore dhe mundësi punësimi në institucione të ndryshme. <i>Evidence _Tabelat Permbledhese</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Departamenti përgjegjës, përmes programit të studimit, ofron kurrikul të pasur e të përshtatshme për studentët që duan të bëhen pjesë e profesionit në fushën e arsimit, duke u krijuar mundësi dhe orientuar drejt marrjes së certifikatave të ndryshme në këtë fushë për të gjetur vendin e tyre në fushën e edukimit.  <i>Vizita ne IAL</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Nga vizita në institucion GVJ konstaton se programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian.  <i>Vizita ne IAL</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia përgjegjëse mbështet grupet e lëndëve dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore si dhe ofron pëdorimin e infrastrukturës për realizimin e objektivave të projekteve.</li> <li>- Institucioni organizon konferenca shkencore dhe ëorkshope ku marrin pjesë me referime stafi akademik dhe kërkimor. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve në konferenca shkencore.</li> <li>- Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dokumente si: rregullore e programit të studimit, rregullore e Fakultetit, rregullore e Departamentit, dhe në planin mësimor ngarkesa ndahet në leksione, seminare. Format e mësimdhënies në UAMD paraqesin veçori, pasi orët e mësimit janë të pandara në leksione e seminare, në shumë raste i njëjti pedagog zhvillon leksionet dhe seminarët. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët.</p> <p><i>Evidencë 4_Rregullore e Universitetit</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>UAMD, përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut. Procesi i mësimdhënies kryhet nga ana e personelit akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, duke iu përgjigjur nevojave e interesit të studentëve. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga ekspertë të fushës së arsimit, mësim në laboratore, seanca diskutimesh. Gjatë periudhës së pamdemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave Teams, Classroom, Moodle. UAMD mundësoi edhe trajnime për përdorimin e këtyre platformave për personelin akademik, duke përgatitur edhe manual përrdorimi për studentët. Departamenti përgjegjës monitoroi zhvillimin e mësimit online, përmes raportimeve nga vetë platforma dhe evidentimi i tyre me formularë përkatës për çdo lëndë e çdo lektor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMD përmirëson në mënyrë të vazhdueshme aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie, apo aftësitë didaktike përmes marrjes së eksperiencave si brenda vendit edhe jashtë vendit, këto të fundit përmes shkëmbimeve të trajnimit me universitete të huaja në zbatim të programeve Erasmus+, financuar nga KE. Bashkëpunimet janë të mbështetuara në marrëveshje të lidhura mes UAMD e institucioneve të tjera publike dhe private. <i>GVJ konstaton se numri i personelit akademik efektiv të përfshirë në mobilitete nuk është shumë i lartë.</i></p> <p><i>Evidence 42_Tabelat Permbledhese</i></p>
	<p><i>Dokumentat nga Vizita në institucion: Evidence Nr.5 Drejtoria e Projekteve dhe Marredhënieve me Jashte</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Në UAMD personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë të fituar brenda e jashtë vendit, është me eksperiencë disa vjeçare e me përvojë në mësimdhënie si në universitete shtetërore dhe në ato private. Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminarëve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes duke përfshirë edhe studentët në diskutim. Përveç kësaj përfshirja e studentëve bëhet edhe përmes konferencave studentore apo përmes pjesmarrjes në projekte të ndryshme në institucione të tjera.</p> <p><i>Evidencë 8_Personeli akademik në FTI</i>  <i>Evidencë 9_Personeli akademik ne DM</i>  <i>Evidencë 13_Cv e Lektoreve</i>  <i>Evidencë 14_CV e stafit ndihmës akademik FTI</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Dokumentohet se Departamenti përgjegjës për programin e studimit zhvillon analiza vjetore si për mësimin edhe për punën kërkimore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve / disiplinave. Në këtë analizë vjetore departamenti vlerëson përputhshmërinë e metodave të mësimdhënies me objektivat formues, të përcaktuar në dokumenta si: rregullore e Fakultetit, rregullore e programit të studimit. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga NjSBC.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidence 31_Rregullore e Programit MMI</i>  <i>Evidencë 22_Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, dokumentacioni shoqëruar I raportit si dhe vizita në UAMD rezultojnë se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Kështu, është ngritur me vendim të titullarit të institucionit NjSBC në rang universiteti, është miratuar edhe rregullorja e kësaj njësie, me qëllim mbështetjen, motivimin, nxitjen e mësimdhënies me metoda inovative, për të tërhequr vëmendjen e studentëve, për ta bërë mësimin më interaktiv. UAMD ka të saktësuar në politikat e veta edhe trajnimin e personelit akademik, si dhe sigurimin e kushteve për pjesmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+.</p> <p><i>Evidence 23_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD bën përpjekje të vazhdueshme për të garantuar procesin e të nxënies, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, dhe ka ndërtuar proceset e duhura në këtë drejtim</li> <li>- UAMD mbështet kualifikimin në drejtim të përmirësimit të kompetencave didaktike të stafit.</li> <li>- Programi i studimit përmban formë të shumëllojshme të mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të</li> </ul>



	<i>institucionit me qëllim funksionimin dhe arritjen e synimeve të programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Konstatohet se mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive kryhet në bazë të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, neni 68, pika 1- 6, në rregulloren e Fakultetit, neni 59, dhe në rregulloren e provimeve, neni 2, shihet se studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre, përmes skemës së vlerësimit me pikë dhe të konvertuara në notë, konkretisht pikët totale ndahen në këtë mënyrë: në pjesmarrje e aktivizim në leksione e seminare, testi i ndërmjetëm, projekti apo detyra e kursit, provimi përfundimtar. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve që ditën e parë të nisjes së lëndës, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës. <i>Evidencë 4_Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i> <i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	<i>Evidencë 4_Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i> <i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Për këtë program studimi vlerësimi i studentëve bëhet përmes 4 elementëve: vlerësimi për aktivizimin, për testin e parë apo të ndërmjetëm, për detyrën apo projektin e kursit dhe vlerësimi për provimin përfundimtar. Totali i pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në syllabusin e lëndës si dhe aktet rregullatore të institucionit. <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i> <i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  - <i>Vlerësimi përfundimtar i studentit kryhet nëpërmjet vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testimeve të lëndës.</i>  - <i>Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve si dhe rregulloren e programit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të Studimit përcaktohet mënyra e vlerësimit të njohurive, aftësive të përfituara e cila bazohet në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e Fakultetit neni 59 dhe 63, në rregulloren e provimeve, neni 2, në syllabuset e lëndëve mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga ana e studentëve të këtij programi studimi. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke grumbulluar pikët e pjesmarrjes së aktivizimit në mësim, të provimit të ndërmjetëm, të detyrës së kursit dhe të provimit përfundimtar. Studentët kanë mundësi të hyjnë në provim për të marrë notë kaluese apo për përmirësim note tre herë, në sezonin e dimrit, në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i>  <i>Evidencë 40_Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rëndësia e transparencës dhe e origjinalitetit merret përsipër nga studenti që në momentin e regjistrimit dhe plotësimit të dokumentacionit ku vihet në dijeni për platformën e përdorur me synim rritjen e transparencës dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve. Platforma e përdorur për korrigjimin e provimeve është Clean Score. Përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve dhe kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. Parashikohet në rregulloren e programit të studimit, neni 14 edhe forma të tjera testimi bazuar në llojin e lëndës si dhe mundësisë së zhvillimit në laborator apo në auditor. Sipas legjislacionit në fuqi dhe dokumentave të programit të studimit, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program.</p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u informuan që gjatë orës së parë të mësimit profesorët qartësojnë mënyrën e vlerësimit të lëndës dhe i mbështesin për të kuptuar si duhet të qasen në raport me lëndën, mënyrën e testimit, angazhimin në klasë apo zhvillimin e detyrave. Studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementeve, jo vetëm me provim por edhe përmes detyrës apo projektit të kursit. Studentit i jepet mundësia të diskutojë në klasë rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar. Detyra e kursit si punë në grup dhe prezantim në klasë si grup i nxit studentët të përmirësojnë vlerësimin e tyre krahasuar me vlerësimin që kanë patur në provim.</p> <p><i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit, procesi i provimeve zhvillohet më të paktën dy vetë komision provimi, lektori dhe pedagogu i seminareve, për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin. Po kështu, vendosja e një programi antiplagjiaturë në fakultet i mundëson pedagogëve të diktojnë nëse ka patur plagjiaturë në detyrat e kursit apo mikrotezat e dorëzuara për vlerësim.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e provimeve si edhe në syllabusin e lëndës. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipar informimit që u është bërë studentëve për shpalljen.</p> <p>Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjësit të njesisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore, në zbatim të rregullores së Fakultetit.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, në rregulloren e provimeve si edhe në syllabusin e lëndës. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen.</p> <p>Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjësit të njesisë bazë për të rivlerësuar rezultatin, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore, në zbatim të rregulloreve përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidencë 31_Rregullore e programit të studimit MMI</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat rrisin transparencën e vlerësimit. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i></li> <li>- <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit.</i></li> <li>- <i>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</i></li> </ul>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Në bazë të dokumentave dhe vizitës në UAMD, konstatohet se programi i studimit është i përshtatur me kërkesat e tregut të punës, ndaj edhe i përgatit studentët për në fushën e mësimdhënies në matematikë dhe informatikë. Kjo bën që kurrikula e këtij programi studimi të synojë përgatitjen e pajisjen e studentëve me njohuri të mira teorike dhe praktike.  <i>Evidencë 31_ Rregullore e programit të studimit MMI</i> <i>Evidencë 41_ Plani mesimor MMI</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit, ka si synim plotësimin e kërkesave të tregut në fushën e edukimit dhe mësimdhënies, garanton zhvillimin e aftësive të studentëve në disa disiplina të ndërlidhura me ato të matematikës dhe informatikës, të tilla si teknologjia e informacionit. Kështu nëse i referohemi planit mesimor, gjenden të ndërthurura disiplina sipas kategorizimit A/B/C/D/E. Syllabuset e lëndëve, të paraqitura në të dy gjuhët shqip e anglisht, saktësojnë metodologjinë e mësimdhënies, mësimi zhvillohet në laborator dhe klasa, për të aftësuar studentët për përvetësimin më të mirë të dijeve.  <i>Evidencë 40_ Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i> <i>Evidencë 41_ Plani mesimor MMI</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar në VKM 41/2018, në Rregulloren e Programit të Studimit, syllabusi përmban objektivat e të nxënimit, metodologjitë e të nxënimit, mënyrën e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit. Në përfundim të lëndës (në fund të semestrit) pedagogët e lëndës realizojnë përsëritje të lëndës, ushtrimeve, rasteve, për të shqyrtuar kompetencat e studentëve të marra gjatë zhvillimit të lëndës, por dhe për të orientuar studentët për provimin përfundimtar. Departamenti shpall edhe orët e konsultimeve për çdo pedagog, po kështu edhe pushimi disa ditore për çdo provim ndihmon studentët të përsërisin lëndën. Në fund të vitit lektorët së bashku me koordinatoren e programit të studimit orientojnë studentët për detyrimet përmbyllëse, si praktika mësimore dhe mikroteza.  <i>Evidencë 31_ Rregullore e programit të studimit MMI</i> <i>Evidencë 41_ Plani mesimor MMI</i>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në	Në UAMD, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret e programit të studimit, studentëve u jepet mundësi në disa lëndë me orientim praktik, të zhvillojnë njohuritë e marra në leksion apo duke kryer praktikat profesionale, në institucione të fushës së edukimit. Kështu, bazuar në rregulloren e Praktikës Mësimore, në përfundim të ciklit të studimit, studentët zhvillojnë deri në një semestër praktikë mësimore. Për këtë institucioni suporton studentët të kryejnë praktika profesionale pranë institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Personeli akademik

interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	i programit të studimit krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, për të krijuar mundësi të mëtejshme studimi e kërkimi shkencor, duke i mbështetur studentët për pjesmarrje me punime të përbashkëta me pedagogët apo për të organizuar konferenca studentore.  <i>Evidence_ Tabela permbledhese</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë apo me kontratë, përpos orëve të planifikuara të leksioneve e seminareve, informojnë studentët për leksione të hapura nga profesionistë të fushës, për të rejtat dhe risitë në fushën e edukimit dhe mësidhenies.  <i>Evidence _ Tabela permbledhese</i>								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UAMD e Fakulteti mbështesin dhe nxisin studentët të marrin pjesë në trajnime, të nxiten për shfaqjen e ideve inovative, përmes punimeve kërkimore, pjesmarrjes në konferenca, në aktivitete të përbashkëta me institucione të kësaj fushe. GVJ konstatoi se institucioni i mbështet financiarisht studentët.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Syllabuset e lëndëve ofrojnë njohuri të mjaftueshme për të kompletuar studentët me kompetenca në fushën e Matematikës dhe Informatikës</li> <li>- Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup dhe krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Baza ligjore për saktësimin e detyrimeve përmbyllëse të studentit, pra praktika mësimore dhe diploma apo mikroteza i përmbahet VKM 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 879, datë 18.12.2019, nenit 75 të rregullores së UAMD, nenit 68 të rregullores së Fakultetit, nenit 17 të rregullores së programit të studimit.  <i>Evidencë Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015,</i> <i>Evidencë Rregulloren e UAMD</i> <i>Evidencë Rregulloren e FTI</i> <i>Evidencë Rregulloren e Programit të Studimit</i>



<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Evidentohet se UAMD njofton studentët përmes seancave orientuese në auditorë nga pedagogët, nga koordinatorët e programit të studimit, por edhe përmes njoftimeve në faqen e fakultetit për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si gjatë vitit akademik edhe në fund të vitit për detyrimet e tyre përmbyllëse. Që në muajin e parë të fillimit të vitit akademik, Departamenti u bën të njohur studentëve të vitit II, të programit MSH në MMI procedurën përfundimtare të diplomimit. Studentët zgjedhin të zhvillojnë temë diplome, dekanati i FTI përcakton një lektor udhëheqës me kohë të plotë, bazuar në kërkesën e studentit dhe propozimin e Departamentit.</p> <p><i>Evidencë Rregulloren e FTI</i>  <i>Evidencë Rregullore DM</i>  <i>Evidencë Rregulloren e Programit të Studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në UAMD, për këtë program studimi nuk zhvillohet provim final. Referuar rregullores së diplomimit dhe planit mësimor, detyrimet përmbyllëse realizohen përmes praktikës mësimore dhe përgatitjes e mbrojtjes së mikrotezës.</p> <p><i>Evidencë 41_Plani mesimor MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas rregullores së Diplomimit të UAMD dhe Fakultetit përcaktohen detyrat kryesore të personelit akademik për punimin e diplomës. Njesia bazë miraton temat e mundshme për t'u pr zgjedhur nga studentët. Pedagogët udhëheqës në bashkëpunim me studentët zgjedhin temën që do përgatitet nga student. Pedagogu orienton studentin për strukturën e punimit, për nxjerrjen e rezultateve, formulimin e konkluzioneve e sugjerimeve. Në fund bëhet miratimi dhe vlerësimi i punimit të diplomës së studentit nga ana e pedagogut, para se të dorëzohet tema në departament për evidentim, para mbrojtjes në komision. Caktohen komisionet e mbrojtjes së diplomave nga ana e njesisë bazë, të cilat miratohen nga drejtuesi i njesisë kryesore.</p> <p><i>Evidencë 4_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i>  <i>Evidencë 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe dokumentacionit vënë në dispozicion, UAMD, Fakulteti dhe Departamenti kanë në dispozicion të studentëve laboratorë me kompjutera, bibliotekë si fizike dhe on line, mjedise studimi. Sipas marrëveshjeve me institucione të ndryshme, fakulteti krijon mundësi për përfitime të njohurive nga studentët përmes praktikave profesionale, mësimore. Për natyrën e programit të studimit Universiteti dhe departamenti mbështet studentët, në përdorimin e ambienteve të bibliotekës si dhe laboratorit të IT. UAMD krijon mundësi për studentët për përgatitjen e detyrave të kursit gjatë vitit, por edhe për përgatitjen e punimit të diplomës, përmes laboratorëve që ka vënë në dispozicion, përmes bibliotekës on line.</p> <p><i>Evidencë_Tabela permbledhese</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, në veçanti në rregulloren e diplomimit, saktësohet se në përfundim të mbrojtjes së diplomës para komisionit studenti vlerësohet me notë. Forma e diplomës dhe suplementi i diplomës</p>



punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	janë të miratuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Tema e diplomës në MMI ka 12 kredite. <i>Evidence 4_Rregullore e Universitetit_Aleksandër Moisiu_Durrës</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	UAMD sipas rregulloreve të miratuara në zbatim të Ligjit 80/2015, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Studenti njoftohet të tërheqë diplomën dhe suplementin e diplomës, në përfundim të studimeve. Dokumentacioni ofrohet në shqip dhe në anglisht  <i>Evidence 4_Rregullore e Universitetit_Aleksandër Moisiu_Durrës</i> <i>Evidence 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UAMD e ka të detyrueshme të ruajë e të arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentët nëse kërkohet.  <i>Evidence 4_Rregullore e Universitetit_Aleksandër Moisiu_Durrës</i> <i>Evidence 5_Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në procesin e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse.</i></li> <li>- <i>UAMD parashikon në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për përgatitjen për detyrimet përmbyllëse të programit të studimit.</i></li> <li>- <i>Në përfundim të ciklit të studimeve, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomën dhe suplementin e saj.</i></li> <li>- <i>Dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format	

dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

**Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Në mënyrë të detajuar personeli akademik i angazhuar me kualifikimin përkatës jepet në vijim:

Kualifikimi i stafit akademik të PS	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	4	1	4	1	4	1
Dr/Phd	11	1	11	1	11	1
Msc.						
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>2</b>

Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.  
*Evidenca: Tabela përmbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike Tabela 7.2*  
*Evidenca: 13 Cv e Lektoreve*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ konstaton se personeli akademik me kontratë është i kufizuar në numër krahasimisht me personelin akademik efektiv. Bazuar në tabelat përmbledhëse, për vitin akademik 2022-2023 ngarkesa mësimore është realizuar në masën 89.5% nga personeli akademik efektiv (PAE).  
*Evidenca: Tabela përmbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike. Tabela 12.2.1*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në tabelat përmbledhëse si dhe nga verifikimet gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në vitet e fundit ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Si institucion publik, UAMD garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore ose semestrale.

	<p><i>Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike Tabelat 6.2.1-3</i></p> <p><i>Takimi në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Mosiu” Durrës (UAMD) ndjek me përpikmëri bazën ligjore për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i UAMD përmban procedura transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të personelit. Kjo mënyrë siguron që kandidatët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Gjithashtu kriteret e përcaktuara në dokumentin e politikës së rekrutimit, sigurojnë rekrutimin e personelit me arritje të larta akademike, me tituj dhe grada shkencore. Kriteret për rekrutimin e tyre lidhen me aftësitë akademike të fushës përkatëse ku do të shërbejnë.</p> <p><i>Evidenca: 4 Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i></p> <p><i>Takimi në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi ambjentet dhe laboratorët. Në strukturën e FTI aktualisht janë 10 personel ndihmës akademik. Nga shqyrtimi i CV të personelit ndihmës-akademik që kontribuon në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë- Informatikë GVJ konstaton se kemi të bëjmë me personel ndihmës-akademik me kualifikim në fushën e informatikës apo teknologjisë së informacionit në nivelin Master i Shkencave apo Master Profesional. Në këtë mënyrë disponohet niveli i duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua për kontributin nga ana e këtij personeli në instalimin e programeve informatike, mirëmbajtjen e laboratorëve etj.</p> <p><i>Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike: Tabela 1, Tabelat 2, Tabela 16</i></p> <p><i>Evidenca: 14 CV e stafit ndihmës akademik FTI</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyrat përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ, në UAMD, janë zyra e Burimeve Njerëzore dhe zyra e Arkiv-Protokollit. GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore e cila ka në përbërje 5 specialistë (nga një për çdo fakultet). GVJ konstatoi se kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik. Përsa i përket informacionit në lidhje me angazhimin e çdo anëtari të personelit akademik dhe ndihmës akademik në çdo semestër dhe vit akademik, ky informacion administrohet nga FTI si dhe nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Çdo vit akademik përditësohen CV-të e pedagogëve, ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. Departamenti dhe NJSBC disponon ngarkesën mësimore të secilit pedagog/e për secilin semestër, si dhe oraret mësimore për pedagogët, bashkë me programet lëndore ku pedagogu/ja është titullar/e apo lektor/e e</p>



	<p>lëndës. Po ashtu, çdo fillim viti dhe semestri përcaktohet ngarkesa mësimore për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë 63 marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare institucione ose kompani. Këto marrëveshje kanë shërbyer kryesisht për realizimin e praktikave profesionale si dhe për elementë të projekteve në kuadër të procesit mësimor. Referuar takimeve në institucion, për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit FTI ka vënë në dispozicion staf të kualifikuar, me tituj. Mënyra e ndjekjes dhe vlerësimit të praktikës paraqitet në Rregulloren e praktikës mësimore. Studentët e kanë lëndë më vete praktikën profesionale. Për studentët e këtij programi FTI / UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me DAR për zhvillimin e praktikave profesionale Për shumë nga lëndët e formimit profesional ata zhvillojnë praktika të tyre në labororet e FTI. Elementë praktikë të përvehtësimit të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës.</p> <p><i>Evidenca 12 Laborator FTI</i></p> <p><i>Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike Tabela 5</i></p> <p><i>Evidenca: Plani mesimor MMI</i></p> <p><i>Evidenca: 30 Rregullore e praktikës MMI</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktika shkollore, e integruar dhe e mësimdhënies për degën e Master në Mësuesi në Matematikë-Informatikë zhvillohen nëpër shkollat e përcaktuara nga Drejtoritë Arsimore. Praktika e integruar dhe e mësimdhënies mund të zhvillohet edhe pranë rrethëve të vendbanimit të studentëve. Lektorët udhëheqës të praktikave merren me orientimin e studentëve praktikantë dhe mundësojnë lidhjen e këtyre të fundit me drejtoritë e shkollave ose institucionet e ndryshme me të cilat Fakulteti ka nënshkruar më parë një marrëveshje. Ata e takojnë mësuesin tutor para se të fillojnë praktikën në mënyrë që të trajtojnë tema dhe çështje që lidhen me fillimin e shkollës. Praktika e tyre fillon zyrtarisht javën e parë të mësimin në Universitet. Shuma totale e orëve të praktikës në secilin semestër është 120 orë nga të cilat 60 orë zhvillohen pranë shkollave përkatëse dhe 60 orë në auditor me lektorin udhëheqës. Mësuesi tutor angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidenca: 30 Rregullore e praktikës MMI</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Personeli akademik i angazhuar në programi Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor si dhe fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv në vitin 2022-2023 ishte rreth 89.5%, duke qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</li> <li>- Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UAMD.</li> <li>- Praktika shkollore, e integruar dhe e mësimdhënies për degën e Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë zhvillohen nëpër shkollat e përcaktuara nga Drejtoritë Arsimore.</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UAMD zhvillon aktivitetin në dy godina: Godina Qendrore (Currila) me sipërfaqe 6000 m2 dhe Kampusi Spitallë me dy godina (me sipërfaqe rreth 20000 m2). Programi i studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë, i cili mbulohet nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, realizohet në Godinën Qendrore (Currila) dhe për realizimin e procesit mësimor janë vënë në dispozicion ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seancave laboratorike. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GVJ konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. 1 salle aktivitete promovuese dhe 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale si dhe zyra për stafin.</p> <p>Institucioni ka dhe bibliotekën dhe 1 zyrë informacioni për studentë.</p> <p><i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)</i></p> <p><i>Evidenca. <a href="https://uamd.edu.al/kampusi/">https://uamd.edu.al/kampusi/</a>.</i></p> <p><i>Evidenca: 12 Laborator FTI</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. FTI zotëron 3 laboratorë programimi (sallat 101, 111 dhe 211) të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili, 2 laboratorë të profilit të multimedias (sallat 103 dhe 203), një laborator kërkimor (salla 015) dhe VTech Hub (401). Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët.</p>

	Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimin me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve. <i>Vizita e GVJ në institucion</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	FTI për lëndët dhe programet e Informatikës ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 6 laboratorë kompjuterash dhe pajisjesh multimediale bashkëkohore. Të gjithë kompjuterat janë arkitekturë workstation me parametra të lartë teknike, dhe programe të nevojshme për lëndët. GVJ është e mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.  <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca: 12 Laborator FTI</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Laboratorët e informatikës, janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.  <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca: 12 Laborator FTI</i> <i>Evidenca: 14 CV e stafit ndihmës akademik FTI</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Praktika shkollore, e integruar dhe e mësimdhënies për degën e Master në Mësuesi në Matematikë-Informatikë zhvillohen nëpër shkollat e përcaktuara nga Drejtoritë Arsimore, të cilat kanë mjediset e mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave shkollore. Fakulteti ka nënshkruar më parë një marrëveshje me drejtoritë e shkollave ose institucionet e ndryshme përpara se studentët të fillojnë praktikën. Elementë praktikë të përvehtësimin të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës.  <i>Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca: 12 Laborator FTI</i> <i>Evidenca: 30 Rregullore e praktikës MMI</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se:</i>  - <i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i>



	<p>- <i>Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</i></p> <p>- <i>Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se UAMD dhe FTI kanë vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e UAMD, Currila, në hapësirën e dedikuar fushës së teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht).</p> <p><i>Dokumenta nga Takimi: Literatura ne biblioteke dhe marreveshje per biblioteken online</i></p> <p><i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17).</i></p> <p><i>Vizita në biblioteke</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seancave praktike të rehat që lidhen me lëndët përkatëse. Në syllabus bëhet pasqyrimi i përditësimit të literaturës së rekomanduar nga personeli akademik përgjegjës për lëndën. Syllabuset miratohen çdo fillim semestri në departament. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes se vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i></p> <p><i>Evidenca: Syllabuset Master Mesuesi MMI 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Biblioteka e UAMD, në degën e Currilave, është e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me poste leximi dhe 10 kompjutera në dispozicion. Në bibliotekë gjenden 12000 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Fondi shqip dhe i huaj mbulon të gjithë fakultetet e universitetit. Literatura është bashkëkohore, kryesisht shkencore me moshë</p>



<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>mesatare 5-10 vjeçare. Biblioteka ka tri vendndodhje nga të cilat në Godinën Universitare në Currila mbulon Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Biblioteka është e abonuar ne revista shkencore on-line si Koha, Cobiss, U-LIBRAY, Jstore që lejon aksesimin e informacioneve të pasura dhe bashkëkohore.</p> <p><i>Dokumenta nga Takimi: Literatura ne biblioteke dhe marreveshje per biblioteken online</i></p> <p><i>Evidenca: Tabelat përmbledhëse: Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17).</i></p> <p><i>Vizita në biblioteke</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UAMD në Godinën Universitare në Currila, e cila mbulon Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme. GVJ vëren se Biblioteka mbulon të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lëndë nga pedagogët përkatës. Në ndihmë të studentëve është janë dhe bibliotekat on-line të cilat mundësojnë të sigurohet aksesimi në një literaturë të gjerë dhe të përditësuar në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze dhe studentët preferojnë këtë opsion.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ofron edhe U-library pjesë e rrjetit të IAL-ve publike mundësuar nga Rrjeti Akademik shqiptar. UAMD ka akses edhe në bibliotekën digjitale JSTOR e cila ofron më se 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik. Gjithashtu, biblioteka e UAMD është bërë pjesë e Programit Cobiss, duke mundësuar në këtë mënyrë qasje online në një numër të madh bazash të dhënash të bibliotekave të ndryshme. GVJ në vizitën e tij në Bibliotekë, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online, që siguron qasje në revista akademike, libra dhe burime kryesore. Cdo student e pedagog ka të drejtë anëtarësimi falas në bibliotekë.</p> <p><i><a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a></i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></i></p> <p><i><a href="https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search">https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search</a></i></p> <p><i><a href="https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/libraries">https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/libraries</a></i></p> <p><i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përbushur nevojat e studentëve. Gjithashtu studentët kanë mundësinë të aksesojnë bibliotekën online nëpërmjet sistemit Pitagora (nëpërmjet të cilit bëjnë dhe regjistrimin në bibliotekën online).</p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/">https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</a></i></p>

	<i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtëj tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në UAMD është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit (gjatë gjithë javës në orarin 8:00 deri 16:00). Salla është komode dhe me kushte të përshtatshme për të punuar në ambientet e saj. Gjithashtu Shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik) ofrohet në orarin 8:00-20:00, nga e hëna në të dielë.  <i>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</i> <i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një fryme bashkupunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programit të studimit depozitojnë gjithmonë në bibliotekë një kopje të materialeve të leksioneve, nëse nuk ka libra si fond fizik. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në të gjitha fondet online.  GVJ konstaton përpjekje të institucionit për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.  <i>https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/</i> <i>Vizita GVJ në institucion</i> <i>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibliotekë</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se</i>  <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Literatura bazë e programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj.</i></li> <li>- <i>Biblioteka është në dispozicion të studentëve të programit të studimit gjatë gjithë javës në orarin 8:00 deri 16:00.</i></li> <li>- <i>Është siguruar akses në biblioteka online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit, sistemin Pitagora. Sistemi i integruar i informacionit (Pitagora) është në bashkëpunim me projektin e RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar). Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e financës për verifikimin e pagesave. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a></i>  <i><a href="https://uamd.pitagora.rash.al/login">https://uamd.pitagora.rash.al/login</a></i>  <i>Vizita e GVJ në institucion</i>  <i><a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FTI/ UAMD e administron informacionin dhe dokumentacionin e tyre që lidhet me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpërmjet sistemit Pitagora dhe zyrës së Burimeve Njerëzore. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione për personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Personeli akademik joefektiv nëse ka qenë i angazhuar një vit më parë në UAMD nuk është e nevojshme të sjelli gjithë dokumentacionin e aplikimit, por vetëm kërkesëne, vërtetim page dhe vërtetime nëse ka pasur ndryshime në titujt akademik.</p> <p>Në sistemin Pitagora ruhet informacion i personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit për çdo vit akademik. Sistemi Pitagora i zhvilluar nga RASH ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Aksesin në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj.</li> <li>- Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj.</li> <li>- Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.</li> <li>- Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera.</li> </ul> <p><i><a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></i>  <i>Vizita ne Institucion</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimet, ashtu edhe jashtë saj. Sipas profileve të personelit dhe studentëve, sistemi Pitagora siguron module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Personeli ka informacion për studentët sipas profileve dhe degëve të studimit, për çdo modul ku është i aktivizuar. Në përfundim të zhvillimit të modulit ruan rezultatet e secilit student dhe ky informacion i komunikohet çdo studenti në profilet përkatëse.</p> <p>Përveç sistemit Pitagora, nga ana e stafit akademik dhe studentëve përdoren gjerësisht edhe platforma të tilla si Google Classroom dhe MS Teams. Përdorimi i këtyre platformave mundëson transmetimin nga ana e pedagogëve të leksioneve, materialeve që lidhen me kërkesat e detyrave të kursit, zhvillimin e seancave laboratorike etj si dhe postimin nga ana e studentëve të zgjidhjeve dhe realizimit të detyrimeve përkatëse.</p> <p>Informacione të detajuara për aktivitete të ndryshme, kuadrin ligjor, kërkimin shkencor, vendime të Senatit akademik dhe Rektoratit, transparencën, shërbime që ofrohen etj jepen dhe në faqen web të UAMD.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion.</i>  <a href="https://www.uamd.pitagora.rash.al/">https://www.uamd.pitagora.rash.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Çdo përdorues në sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FTI/UAMD. Gjithashtu, në dispozicion janë platformat Google Classroom dhe MS Teams dhe faqja zyrtare e UAMD ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. Sistemi Pitagora garanton në një masë të madhe monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, si ruajtja e monitorimi i pagesave nga zyra financiare për studentët, dhe mundësimin e raportimeve individuale dhe të dhënave në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion.</i>  <a href="https://www.uamd.pitagora.rash.al/">https://www.uamd.pitagora.rash.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të FTI gjendet informacion për programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Informacioni në faqen web ofrohet në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe italisht</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/matematike-informatike/">https://uamd.edu.al/matematike-informatike/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD disponon sistemin Pitagora, një sistem i brendshëm i menaxhimit institucional që bën edhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë.</i></li> <li>- <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre mbahet nga Sekretaria Mësimore dhe menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit Pitagora.</i></li> <li>- <i>Sistemi Pitagora ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe studentët, pedagogët, etj për menaxhimin e të gjithë ciklit</i></li> </ul>




	<p><i>akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në kurse, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar</i></li> <li>- <i>Informacionet për programin Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë publikohen në tre gjuhë në faqen zyrtare të UAMD në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UAMD harton raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to raportohet gjithashtu për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet nga Administratori i FTI, ndërsa në nivel institucioni nga Administratori i UAMD dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatën akademik dhe Rektoren e UAMD. Buxheti i UAMD-së alokohet sipas Njësive Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. Raportet financiare nuk detajohen në nivel programi studimi ndaj nuk është i mundur vlerësimi më i detajuar i kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UAMD, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit <u>Aleksandër Moisiu</u> Durrës. Takime në Institucion. Evidenca: RVB Mësuesi në Matematikë Informatike Evidenca: Tabela përmbledhëse Bachelor Matematikë Informatike MSc. Mësuesi në Matematikë Informatike (Tabela 18)</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se në raportimin e publikuar nga UAMD janë të pasqyruara në nivel institucioni plani dhe realizimi i financimeve për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p>Në Statutin e UAMD përcaktohet edhe burimet e financimit të institucionit. Burimet kryesore të financimit për këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Buxheti i Shtetit.</li> <li>- Pagesat e studentëve për arsimim.</li> <li>- Të ardhurat për shërbimet e kryera.</li> <li>- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta.</li> <li>- Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.</li> <li>- Veprimtari kërkimore – shkencore.</li> <li>- Projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> </ul> <p>Vihet re se pjesa dërmuese e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje në veçanti për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raportimi-i-muajit-Dhjetor-2022-TAB">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raportimi-i-muajit-Dhjetor-2022-TAB</a>  Evidenca: 2. Statuti i Universitetit <u>Aleksandër Moisiu</u> Durrës.  Evidenca: Tabela përmbledhëse Bachelor Matematike Informatike MSc.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Analiza financiare dhe realizimi i zërave të investimit dhe shpenzimet është subjekt i kontroleve periodike nga Administratori i institucionit dhe sektori i Administrimit Financiar. Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të UAMD dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit <u>Aleksandër Moisiu</u> Durrës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Informacioni i pasqyruar, mbi realizimin e buxhetit të miratuar, në faqen web të UAMD është në nivel Universiteti.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raportimi-i-muajit-Dhjetor-2022-TAB">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raportimi-i-muajit-Dhjetor-2022-TAB</a>  <a href="https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/">https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni</p>	<p>GVJ konstaton se nga të dhënat e tabelës përmbledhëse për të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e vepritarisë së tij akademike dhe ecurinë normale të programeve të studimit.</p> <p>Sipas viteve këto të ardhura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Viti 2020 – Shuma totale 1 082 354 067</li> <li>• Viti 2021 – Shuma totale 1 076 144 918</li> </ul> 

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Viti 2022 – Shuma totale 1 133 710 586</li> </ul> <p><i>Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike (Tabela 18)</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>UAMD rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë.</i></li> <li><i>Pjesa më e madhe e financimit vjen nga buxheti i shtetit, ndaj duhen bërë përpjekje për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat.</i></li> <li><i>Nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit.</i></li> </ul> <p><i>Nisur nga situata financiare e përgjithshme e UAMD, GVJ mendon se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësuesor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë për më tepër se një cikël të plotë studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështetet në Statutin e UAMD, Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FTI dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FTI zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i></p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Kjo është një nga pikat e politikave të pranimit të studentëve në këtë program studimi. Politikat dhe procedurat e ndjekura nga FTI janë të mirëpërcaktuara në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Matematikës dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse</p> <p><i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i></p>												
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Përcaktimi i kriterëve pranuese të programit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë kalon për miratim në të gjitha njësitet përgjegjëse për këtë program studimi (DM, FTI, Rektorat, Senat akademik, MAS) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në portalin U-Albania për të gjithë maturantët. Në rregulloren e programit të studimit parashikohet edhe pranimi i kandidatëve të huaj.</p> <p>Për tre vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë kanë qënë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="655 1803 1501 2016"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>46</td> <td>0</td> <td>46</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>32</td> <td>0</td> <td>32</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2020-2021	46	0	46	2021-2022	32	0	32
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali										
2020-2021	46	0	46										
2021-2022	32	0	32										



	2022-2023	16	0	16
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.  <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a>  <a href="https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6">https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6</a>  Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI  Evidenca: 19. Vendim Senati per Kuotal  Evidenca: 16. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Referuar takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë. <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kanë të drejtë të kandidojnë për pranim në programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM.</li> <li>- kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj.</li> <li>- shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.</li> <li>- si dhe personat që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe aplikojnë për program të dytë studimi.</li> </ul> <p>Referuar kuotave të propozuara, për vitin akademik 2022-2023, shihet se në totalin e 70 kuotave, ndërmjet të tjerave ka dhe 3 kuota për kategori të veçanta. Komisioni ad-hoc që ngrihet nga Përgjegjësi i DM vendos rregullat materiale dhe procedurale që do të zbatohet për realizimin e procesit konkret të pranimeve.</p> <p>Në faqen web të UAMD publikohen kriteret për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egjiptiane. Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, GVJ konstaton se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në</p>			

	<p>mënyrë rigoroze gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të UAMD (Statut, Rregullore).</p> <p><i>Takime në institucion</i></p> <p><i>Evidenca: 19. Vendim Senati per Kuotat</i></p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i></p> <p><i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i></p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p> <p><i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx</a>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në faqen web të UAMD publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Në mënyrë të veçantë këto kriteret kanë të bëjnë me kandidatët nga republika e Kosovës, kandidatë me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/Procedurat-per-aplikim-NE-NJE-PROGRAM-STUDIMI-PER-KANDIDATE-TE-VECANTE.docx</a>.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion dhe RVB, UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Aktualisht në programet e studimit të ofruara nga FTI janë 82 studentë që përftojnë bursa nga këto politika.</p> <p><i>Takimet në institucion.</i></p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- FTI garanton barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë.</li> <li>- Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</li> <li>- Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</li> <li>- Në faqen web të UAMD publikohen kriteret për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egiptiane.</li> <li>- Në faqen web të UAMD publikohen dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</li> <li>- UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se UAMD/FTI/DM kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin,</p>

	<i>përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Ndër mënyrat për të marrë informacion të plotë, në UAMD, në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqia zyrtare e internetit.</li> <li>• Sekretaria mësimore e cila ju jep informacion të detajuar studentëve për lëndët, kreditet, kalimin në vitin e dytë të studimeve.</li> <li>• Java e orientimit të studentët ku ata informohen për programin mësimor, ambjentet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve.</li> </ul> <p>Burime bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e UAMD. Rregullorja e FTI) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Në to jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimorë, organizimi i grupeve mësimore, procesi i regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë semestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve, rregullat e provimit, ankimimi i provimeve, organizimi i kurseve intensive (për ndjekjen me frekuentim intensiv 2-3 javor të lëndëve të caktuara), përmirësimi i notës, mbrojtja e diplomës etj.</p> <p><i>Takimi në institucion</i>  <i>Evidenca: RYB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FTI. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. Referuar rregullores së programit të studimit dhe nga takimet në institucion, GVJ u informua se për studentët të cilët përfitojnë mobilitete jashtë vendit, në se ata</p>

	<p>fitojnë kredite në institucionet pritëse, këto kredite mund t'ju njihen edhe në UAMD.</p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i>  <i>Takime në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Javën e parë të semestrit organizohen ditë informuese me studentët e vitit të parë ku studentët njihen me një numër elementësh të cilët kanë të bëjnë me jetën studentore në UAMD përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p> <p><i>Takime në institucion</i>  <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <a href="https://www.facebook.com/FTIUAMD">https://www.facebook.com/FTIUAMD</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmbyllëse. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. Studentët të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të FTI, “Kërkesën për tu regjistruar për të mbrojtur tezën e diplomës”. Vlerësimi i punimit të diplomës bëhet me sistemin e notave.</p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <i>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Spektori i Karrierës dhe Alumnit ka hartuar një Material informues për maturantët që duan të vazhdojnë studimet në Universitetin “Aleksandër Moisiu”. Rrjetet sociale si dhe faqja web e UAMD-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p> <p>FTI në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FTI.</li> <li>- Takime informuese në gjimnaze për maturantët.</li> <li>- Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale.</li> <li>- Takime informuese online me grupe maturantësh në rang gjimnazesh.</li> </ul> <p><i>Takime në institucion</i>  <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <a href="https://www.facebook.com/FTIUAMD">https://www.facebook.com/FTIUAMD</a>  <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programit të studimit.</li> <li>- Gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmblylëse.</li> <li>- Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve.</li> <li>- Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</li> <li>- FTI në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturanët</li> <li>- Rrjetet sociale si dhe faqja web e UAMD-së luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</li> <li>- Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Rregullorja e UAMD. Rregullorja e FTI, si dhe Rregullorja e programit të studimit.</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij që në fillim, gjatë javës orientuese. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, etj, është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të UAMD, sistemit të informacionit Pitagora si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom). Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si dhe kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje).</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a></p> <p>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</p> <p>Evidenca: 31. Rregullore e Programit MMI</p>

	<i>Takimet në institucion</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Sistemi Pitagora, faqja zyrtare e internetit dhe klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom) janë disa nga format me anë të të cilave studentët informohen dhe gjejnë informacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët studentët e marrin në javën e parë të zhvillimit të çdo moduli përkatës nga pedagogu i lëndës. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit, kurrikula si dhe kalendari akademik.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a>  <a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a></p> <p><i>Takimet në institucion</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Sektori i Karrierës dhe Alumnit. Shërbimet kryesore që ofron ky sektor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofrimi tek studentët i informacioneve dhe trajnimeve (mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, aftësitë e buta, etj.).</li> <li>• Integrimi i studentëve në përmirësimin e njohjes së cilësive të tyre (identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta, ndërjegjësimi për aftësitë e tyre).</li> <li>• Ofrimi i mundësive për zhvillimin e kompetencave të tyre (duke marrë parasysh aftësitë e menaxhimit të karrierës).</li> <li>• Njohjen me mundësitë e punësimit (oferta për punësim, praktika, vullnetarizëm).</li> </ul> <p>Udhëzuesi i karrierës i përgatitur për këtë qëllim përbën një kontribut me vlerë për orientimin e studentëve. Gjatë takimit me studentë të programit të studimit GVJ u informua se shërbimi i karrierës u dërgon email-e për mundësi punësimi si dhe organizon takime informuese për tregun e punës.</p> <p>Studentët që kanë dëshirë të punësohen në fushën e informatikës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve janë në kontakt të me përfaqësuesit e biznesit. Këta të fundit zhvillojnë në mënyrë periodike trajnime ose testime për identifikimin e studentëve potencial për punësim si dhe informojnë vazhdimisht studentët për kërkesat e tregut të punës dhe për mundësitë e punësimit të tyre në përfundim të programit të studimit dhe në disa raste edhe gjatë kohëzgjatjes së programit të studimit.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/karriera/">https://uamd.edu.al/karriera/</a>  <a href="https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf">https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf</a>  Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</p> <p><i>Takime në institucion</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit	<p>Gjatë javës së parë të orientimit të viteve të para studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacioni për ambientet ku do zhvillohet</p>

<p>mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin Pitagora. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për rregjistrimet, pagesat, notat etj.</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i>  <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a>  <a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a>  <i>Evidenca: RVB Mësuesi ne Matematike Informatike</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet sistemit Pitagora, i cili është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahet dhe mund të aksesohet nëpërmjet platformës Google for Education (Google Drive, Google Classroom).</p> <p><i>Vizita e GVJ në institucion</i>  <a href="https://uamd.edu.al/">https://uamd.edu.al/</a>  <a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a>  <a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Studentët e programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i></li> <li>- <i>FTI shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare web duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë.</i></li> <li>- <i>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve.</i></li> <li>- <i>Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit.</i></li> </ul> <p><i>Sistemi i informacionit Pitagora, ofron informacion në lidhje me programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban</p>	<p>Mbajtja e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit kryhet nga sekretaria mësimore e FTI. Të dhënat përpunohen nga</p>

statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora.

Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve
Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë	2019-2020	47
	2020-2021	23
	2021-2022	38

GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrat themeltar dhe regjistrat të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS.

*Vizitat në institucion*

*Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike (Tabela 23.2)*

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike në sistemin Pitagora dhe në format letër. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç' regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin themeltar të studentëve, regjistri i gjeneraliteteve dhe notave, dhe regjistrat e lëndëve semestrale.

Regjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:

Programi i studimit	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë	2020-2021	46	0	46
	2021-2022	32	0	32
	2022-2023	16	0	16

Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standartet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

*Vizita e GVJ në institucion*

*Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike*

*Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike (Tabela 21.2)*

**Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të

FTI/UAMD përdor sistemin elektronik Pitagora, ku pedagogët, sekretaret dhe studentët kanë profilet e tyre sipas autorizimeve përkatëse. Sekretaria



menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër, në rregjistrat përkatës, si dhe në sistemin Pitagora, ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre përmes sistemit.

*Sistemi Pitagora: <https://uamd.edu.al/pitagora/>. Takimet në institucion*

**Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.). Veprimtaria e Sekretarisë mësimore të FTI mbështetet në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FTI. Neni 64 i rregullosës së FTI përcakton se Sekretaria mësimore e FTI-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Në nenet 66 dhe 67 të rregullosës së FTI përcaktohen qartë detyrat e Kryesekretarisë dhe Sekretarisë mësimore. Kryesekretaria ka varësi të drejtpërdrejtë nga Dekani i FTI, i cili menaxhon procesin e kontrollit periodik të përvitshëm dhe vlerësimin e dokumentimit të gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.

*Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës*

*Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit Vizita e GVJ në institucion*

**Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

DM/FTI/UAMD hartojnë raporte analitike vjetore. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Sektori i Karrierës dhe Alumnit analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:

**Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë**

Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023
Nota mesatare në hyrje	6.1	6.58	-

Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2019-2022 janë:

Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
108	4.6%	17.6%	78 %

Zyra e ALUMNIT ruan kontakte me të diplomuarit përmes adresave të email-it ku i njofton për ofertat e reja të punës, organizon trajnime të ndryshme për

	<p>përgatitjen e tyre për tregun e punës si shkrimi i një CV, etj. <i>Vihet re se interesi i të diplomuarve në mbajtjen e komunikimeve me zyrën e Alumnit është i ulët.</i></p> <p><i>Evidenca: Tabela permbledhese Bachelor Matematike Informatike MSc. Mesuesi ne Matematike Informatike (Tabela 21.2&amp; Tabela 24.2)</i></p> <p><i>Takimet në institucion</i></p> <p><i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p> <p><i>Evidenca: 24. Analize vjetore MI (skan)</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretaria mësimore e FTI mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, rregjistrat themeltar, rregjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik nëpërmjet sistemit Pitagora.</li> <li>- Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</li> <li>- Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Sektori i Karrierës, dhe Alumnit analizon gjendjen e punësimit të studentëve.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se UAMD/FTI dhe DM mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Këshillat e studentëve (Neni 90 në Statutin e UAMD) janë organizime të pavarura të studentëve të UAMD-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të UAMD-së në të gjitha programet e studimit. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme</p>

	<p>kulturore, artistike, sportive etj. Në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe dy përfaqësues të studentëve, duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. (Neni 14 në Statutin e UAMD)</p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <a href="https://uamd.edu.al/per-hapjen-e-procesit-te-aplikimeve-per-anetar-studente-te-senatit-akademik/">https://uamd.edu.al/per-hapjen-e-procesit-te-aplikimeve-per-anetar-studente-te-senatit-akademik/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAMD/FTI kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve të UAMD dhe FTI studentët shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takiment në institucion me studentët, këto pyetësorë realizohen përpara provimeve dhe janë anonime duke shprehur mendimin real të tyre.</p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i>  <i>Evidenca: 21. Pyetësor Student UAMD</i>  <i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të UAMD bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmyjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në tre vitet e fundit. GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i>  <i>Evidenca: 21. Pyetësor Student UAMD</i>  <i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të</p>	<p>Në rregulloret e UAMD dhe FTI janë të përcaktuar qartë mënyra e vlësimit të studentëve për vlerësimin përfudimtar duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p>

<p>rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në FTI/UAMD vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Provimi i parë i ndërmjetëm, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar.</li> <li>Provimi përfundimtar, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar.</li> <li>Detyrat, projektet, esetë, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar.</li> </ol> <p>Në rregulloren e FTI përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit të FTI jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore e cila shkon deri në një shikim eventual të tezës së provimit nëpërmjet një komisioni ad-hoc.</p> <p><i>Evidenca: 4. Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës</i>  <i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>UAMD garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</i></li> <li>- <i>Studentët në UAMD janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i></li> <li>- <i>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të UAMD si dhe përpunimi i pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit</i></li> <li>- <i>Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</i></li> <li>- <i>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit..</i></li> </ul> <p><i>GVJ vlerëson se UAMD/FTI/DM përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në UAMD funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës</li> <li>- Sekretaria Mësimore</li> </ul> <p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ofron këshillime, orientim karriere dhe seminare për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e krijimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti në tregun e punës.</p> <p>Sekretaria mësimore e FTI-së është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit Takime në Institucion</i></p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i></p> <p><i>Evidenca nga vizita: Takimet Informuese per studentet dhe linket online</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhczues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf">https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhczues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf</a>  <a href="https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/">https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me rregjistrimin dhe avancimin akademik të studentëve, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre dhe asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, një rol të veçantë luan dhe pedagogu mentor. Qëllimi kryesor i mentorimit është asistimi, këshillimi, mbështetja e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së studimeve në FTI si dhe përpjekja për të maksimizuar rritjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën akademike, atë profesionale e më gjerë. Mentorimi është një proces edukues në të cilin pedagogu mentor shërben si mësues, inkurajues dhe këshillues me qëllimin përfundimtar të promovimit të zhvillimit profesional dhe personal të tyre. Pedagogu mentor monitoron zhvillimin e studentëve dhe ndërhyr për të ndihmuar përparimin e tyre. Ai asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në varësi të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike zhvillon gjithashtu komunikimin efektiv dhe etik me studentët.</p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i></p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i></p> <p><i>Evidenca nga vizita: Takimet Informuese per studentet dhe linket online</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni,</p>

<p>mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e.</p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <i>Evidenca nga vizita: Takimet Informuese per studentet dhe linket online</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban të dhëna për punësimet pas diplomimit. Gjithashtu ky sektor është struktura përgjegjëse që harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Informimin e studentëve për mundësitë e punësimit (nëpërmjet postës elektronike si dhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese)</li> <li>- Zhvillimin e trajnimeve</li> <li>- Mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar</li> <li>- Krijimin dhe përditësimin e të dhënave për punësimin e studentëve</li> <li>- Asistimin e studentëve për programe bursash jashtë vendit.</li> <li>- Hartimin e raporteve dhe statistikave dhe vënien në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</li> </ul> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i>  <i>Takime në Institucion</i>  <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <i>Evidenca nga vizita: Takimet Informuese per studentet dhe linket online</i>  <a href="https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf">https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf</a>  <a href="https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/">https://uamd.edu.al/modeli-i-planfikimit-te-karrieres/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në UAMD funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Sekretaria Mësimore njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</li> <li>- Pedagogu mentor asiston studentët gjatë formimit të tyre akademik dhe nxit pjesëmarrjen e tyre në jetën social-kulturore dhe në klube studentore dhe aktivitete të organizuara nga FTI.</li> <li>- Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni, dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, etj.</li> </ul> <p><i>GVJ vlerëson se UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e</i></p>

	<i>problematikave. Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Zyra e karrierës i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>FTI e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga UAMD dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 20. Udhëzues per metodat e mesimdhënies</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>DM është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DM. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC. GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidenca: 24. Analize vjetore MI (skan)</i> <i>Takime në Institucion.</i> <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimin të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Evidenca: 5. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit</i> <i>Evidenca: 23 Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i> <i>Evidenca: 21. Pyetesor Student UAMD</i> <i>Evidenca: 22. Analiza e pyetesoreve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimin.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik,</p>



	<p>përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Publikimi i raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies kryhet nga ana e NJSBC, duke i vënë kështu rezultatet e vlerësimit në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara.</p> <p><i>Evidenca: 21. Pyetësor Student UAMD</i>  <i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ) Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhënien-Online.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhënien-Online.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>NJSBC luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Rezultatet e përpunuara publikohen dhe në faqen web të UAMD.</p> <p><i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i>  <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>  <i>Takime në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- FTI e zhvillon programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë në përputhje me standardet e vendosura nga UAMD dhe ato shtetërore të cilësisë.</li> <li>- Staf i akademik i UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, për të rritur kapacitetet didaktike.</li> <li>- NJSBC drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</li> <li>- Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë mundësojnë garantimin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve.</li> <li>- NJSBC publikon raporte të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse, në nivel institucional, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në UAMD janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati Akademik.</li> <li>- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë.</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</li> <li>- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</li> </ul> <p>Përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në nivel Fakulteti janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve.</li> <li>- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program.</li> <li>- Koordinatorët e Programeve.</li> </ul> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë në nivel institucional jepen në Statut (nenet 77, 78, 79, 80, 81), ndërsa detyrat e strukturave në nivel fakulteti janë përcaktuar në Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. GVJ konstaten se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><i>Evidencë 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.</i>  <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në nivel institucional, NJSBC, përbëhet nga 7 anëtarë (5 anëtarë janë përfaqësues të fakulteteve respektive, 1 anëtar është koordinatori institucional si dhe 1 anëtar student). NJSBC e FTI kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Kjo njësi monitoron dhe vlerëson proceset e sigurimit të cilësisë bazuar në manualet dhe treguesit e hartuar nga NJSBC institucionale. NJSBC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm dhe raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj.</p> <p>Investimi në cilësinë e mësimdhënies përbën një përparësi të UAMD Synohet që në vitet 2020-2025, UAMD do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies, ku modeli aktual do të plotësohet dhe kombinohet me metodologji më të kompletuara si: peer to peer, focus group, sondazhe të shpeshta, etj. Investimet në UAMD do të kryhen me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Takime në institucion.</i>  <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i>  <i>Evidencë 6. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i>  <a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të</p>	<p>Akreditimi i jashtëm kryhet periodikisht në UAMD. Institucionit i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh, me Vendimin nr. 18 datë 24.03.2022, të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-</p>

<p>jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Informatikë, me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p><i>Evidenca: 7. RVJ Institucional.pdf</i>  <i>Evidenca: 18 Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimin të stafit akademik nga studentët.</li> <li>- Vlerësimin të lëndës.</li> <li>- Vlerësimin të kënaqësisë së studentëve nga institucioni.</li> <li>- Pyetësori Alumni.</li> <li>- Pyetësorë me stafin akademik dhe atë administrativ mbi vlerësimin e kënaqësisë së tyre ndaj Institucionit.</li> </ul> <p>NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij.</p> <p><i>Evidenca: 21. Pyetesor Student UAMD</i>  <i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i>  <i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në UAMD, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë, garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</li> <li>- NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore, në UAMD.</li> <li>- NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikqyr proceset e vlerësimin të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimin të jashtëm të cilësisë etj.</li> <li>- Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin.</li> <li>- NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mbikëqyrja periodike e programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë bazohet në marrjen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri. Pyetësorët i kushtohen vlerësimit të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik. Departamenti i Matematikës shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. Të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore ndiqen dhe zbatohen.</p> <p><i>Takime në institucion.</i> <i>Evidenca: 24. Analize vjetore MI (skan).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vetëvlerësimit hartohen në nivel institucioni. Në to jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik. Për personelin akademik janë aplikuar “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD”. Këto kritere janë të miratuar në të gjitha nivelet dhe përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi.</p> <p><i>Evidenca: 24. Analize vjetore MI (skan).pdf</i> <i>Takime në institucion.</i> <i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit</p>	<p>Në UAMD përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit, drejtuesi i njësisë bazë si dhe strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në rang institucioni dhe njësie kryesore.</p> <p><i>Evidenca: 15. Urdhër Koordinatorete dhe NJSBC</i> <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>






për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<p>Studentët në UAMD janë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë. Mendimi i tyre merret nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshillit Studentor.</li> <li>- Përfshirjes në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (pjesë e GVB).</li> <li>- Këshillimit me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamentit si edhe përdorimit të zyrave mbështetëse për këtë qëllim.</li> <li>- Përfaqësuesit të studentëve në NJBSC.</li> <li>- Pjesëmarrjes në Senatin Akademik.</li> <li>- Pjesëmarrjes në Këshillin e Etikës.</li> <li>- Pjesëmarrjes në Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit.</li> </ul> <p>Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve nëpërmjet pyetësoreve të studentëve, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë, notën mesatare etj., gjurmimit të studentëve të diplomuar, etj. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion.</p> <p><i>Takime në institucion.</i></p> <p><i>Evidenca: 2. Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 23. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</i></p> <p><i>Evidencë 6. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i>  <a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a></p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në UAMD ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë.</li> <li>- Raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik hartohen në nivel institucioni.</li> <li>- Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion.</li> </ul>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në UAMD, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë, në planin strategjik të institucionit synohet dhe ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta studimi me universitete të huaja, sidomos të programeve që zhvillohen në gjuhën angleze. Objektivi i institucionit është edhe rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare. Këto objektiva strategjike do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë dhe në një përshtatje më të mirë e të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 6. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja "Për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë" përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UAMD, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Edhe plani strategjik i UAMD ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale.</p> <p><i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 6. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Një proces gjithëpërfshirës në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë i garanton ato. Nga takimet në institucion, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse.</p> <p><i>Evidenca: 23. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Takime në institucion</i></p> <p><i>Evidenca: 21. Pyetësor Student UAMD</i></p>

	<i>Evidenca: 22. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në veprimtarinë e saj me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBC mbështetet edhe nga institucioni, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Matematikës. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti. <i>Evidenca: 23. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i> <i>Takime në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Programi i studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë arsimore dhe bizneset. Në aspektin e aktivizimit të aktorëve të jashtëm si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, kryhet edhe "Panairi i Punës dhe Karrierës" i organizuar nga UAMD ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Në panairin e fundit, zhvilluar në prill 2022 morën pjesë rreth 200 biznese nga Durrësi, Tirana dhe më gjerë. Gjithashtu në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit ka ndihmuar organizimi i leksioneve të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit. <i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf</i> <i>Takime në institucion</i> <a href="https://uamd.edu.al/leksion-i-hapur-me-teme-how-to-internationalizeyour-department-and-faculty/">https://uamd.edu.al/leksion-i-hapur-me-teme-how-to-internationalizeyour-department-and-faculty/</a>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatos se:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në UAMD, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</li> <li>- Plani strategjik i UAMD ka në fokusin e tij promovimin e një kulture të vëmendjes ndaj cilësisë nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale.</li> <li>- Ka një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.</li> <li>- NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.</li> <li>- Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë kanë kontribuar dhe Panairi i Punës dhe Karrierës e leksione të hapura.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Rezultatet e tyre publikohen në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve që kanë të bëjnë me institucionin dhe studentët. Në faqen zyrtare web të UAMD bëhen publike rezultate të pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Rektoratit, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj. <i>Evidenca: 23. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf</i> <a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a> (linku Relacion i NJSBC: Mbi raportimin periodik per zhvillimin e mesimdhenies ne klasat virtuale) <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf</a> <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Rregullore-UAMD-.pdf</a> <a href="https://uamd.edu.al/vendime/">https://uamd.edu.al/vendime/</a> <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhenien-Online.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhenien-Online.pdf</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Stafi akademik i Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti i Matematikës informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. GVJ konstaton se informacioni me rezultatet e vlerësimeve të publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit. <i>Takime në Institucion</i> <a href="https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/">https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/</a>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Pasi procesi i anketimeve me studentët (procesi i SBC në përgjithësi) evidenton mangësi dhe dobësi ai shoqërohet me plan masash konkrete për përmirësimin e tyre. Identifikimi i zgjidhjeve dhe zbatimi i tyre realizohet nga drejtuesit e FTI. Nëse ka nevojë për mbështetje fiianciare bashkëpunohet me bizneset. <i>Takime në institucion.</i> <i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UAMD-se, GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që UAMD i jep këtij procesi. <i>Takime në institucion.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike	Hartimi i RVB për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij



<p>me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të UAMD dhe FTI, DM si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Ky proces kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij. Procesi i realizimit të pyetësorëve kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndikim pozitiv, në këtë drejtim, ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat, Këshillin e Etikës, Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së institucionit) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Takime në institucion.</i></p> <p><i>Evidenca: RVB Mesuesi ne Matematike Informatike</i></p> <p><i>Evidenca: 18. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë-Informatikë siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Transparenca e tyre sigurohet nëpërmjet publikimit të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve si dhe nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të rezultateve të përmbledhura të pyetësorëve, Statutit, Rregullores, Vendimeve të Senatit Akademik, Vendimeve të Rektoratit, Vendimeve të Bordit të Administrimit, etj.</i></li> <li>- <i>Stafi akademik i programit vihet në dijeni individualisht për pyetësorin në lidhje me performancën e tij ndërsa DM informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></li> <li>- <i>Grumbullimi i informacionit në mbështetje të hartimit të RVB, anketimet me studentët dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative mundësojnë evidentimin e pikave të forta, problematikave, kërcënimeve dhe kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij.</i></li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Master i Shkencave në "Mësuesi në Matematikë-Informatikë" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës**

**Pikat e forta:**

1. Universiteti "Aleksandër Moisiu" i Durrësit është një institucion i mirë-konsoliduar me një histori shumëvjeçare. Ai ofron infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e programit të studimit.
2. Programi i studimit është i përshtatur me profilin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit, duke u bazuar në interesat e vendit për të përgatitur të diplomuar në mësimdhënie për ciklin parauniversitar.
3. Për suksesin e zbatimit të programit të studimit, është kritik që stafi akademik të ketë një nivel të lartë të kualifikimit. Stafi i programit të studimit posedon kualifikimet e nevojshme dhe një përvojë të gjatë në mësimdhënie, duke garantuar një zbatim të suksesshëm të programit.
4. Në përkrahje të programit, fakulteti ka laboratorë të specializuar në fushën e informatikës, si dhe infrastrukturën e nevojshme për të realizuar programin mësimor dhe punën në laborator.
5. Gjatë periudhës së shqyrtuar, institucioni ka treguar përpjekje në zhvillimin e politikave për të promovuar programin e studimit, duke inkurajuar dhe udhëzuar studentët drejt rolit të mësuesit dhe duke ndihmuar ata të integrohen në tregun e punës.

**Pikat e dobëta:**

1. Stafi akademik efektiv i përfshirë në mobilitete është i pakët në numër.  
[Standardi 3.1 kriteri 3]

**Rekomandime:**

1. Departamenti të intensifikojë përpjekjet për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi të drejtpërdrejta ku i gjithë personeli akademik që kontribuon në ngarkesën mësimore dhe kërkimore të programit të studimit të përfitojë nëpërmjet: mobiliteteve, trajnimeve, projekteve kërkimore shkencore me qëllim nxitjen edhe të rritjes së nivelit mësimor dhe kërkimor në këtë institucion.
2. Institucioni të konsiderojë mundësinë e ofrimit të shërbimeve të konviktit dhe mensës për studentët e këtij programi, duke pasur parasysh nevojat e tyre për akomodim dhe ushqim, si dhe për të krijuar një ambient më të përshtatshëm për qëndrimin dhe angazhimin e tyre në shkollë.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor " Mathematics- Informatics" provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" University**

**Strengths points:**

1. "Aleksandër Moisiu" University of Durrës is one of the most consolidated institutions in the country, with a long history. It provides the necessary infrastructure for the development of the study program.
2. The study program is adapted to the profile and field of activity of the institution, based on the interests of the country to prepare graduates in teaching for the pre-university cycle.
3. For the success of the implementation of the study program, it is critical that the academic staff has a high level of qualification. The staff of the study program possess the necessary qualifications and a long experience in teaching, guaranteeing a successful implementation of the program.
4. In support of the program, the faculty has specialized laboratories in the field of informatics, as well as the necessary infrastructure to carry out the curriculum and work in the laboratory.
5. During the reviewed period, the institution has shown efforts in the development of policies to promote the study program, encouraging and guiding students towards the role of teacher and helping them to integrate into the labor market.

**Weak points:**

1. Mobility of the Academic Staff: The number of effective academic staff involved in mobility is limited.

**Recommendations:**

1. The department should enhance efforts to establish direct cooperation agreements. These agreements will benefit all academic staff involved in teaching and research activities of the study program through mobilities, training, and scientific research projects, thereby promoting an elevation in the institution's teaching and research standards.
2. The institution should consider offering dormitory and canteen services to students in this program to meet their accommodation and dining needs, and to enhance their overall experience and engagement.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X